



# Trafikimi i fuqisë punëtore në Maqedoninë e Veriut: faktorët e rrezikut, tendencat dhe sfidat

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës





# Trafikimi i fuqisë punëtore në Maqedoninë e Veriut: faktorët e rrezikut, tendencat dhe sfidat

Këshilli i Evropës  
dhjetor 2022

---

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



---

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



**BOTIMI NË ANGLISHT:  
LABOUR TRAFFICKING IN  
NORTH MACEDONIA:  
RISK FACTORS, TRENDS AND CHALLENGES.**

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës përmes projektit të përbashkët "Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2022".

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

**Dizajni i kopertinës dhe faqosja:**  
Agjencia për marketing DIVISION

**Foto e kopertinës:**  
Shutterstock

© Këshilli i Evropës, shtator 2022.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

# Përmbajtja

---

<b>Mirënjohje</b>	<b>7</b>
<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>8</b>
<b>I. Hyrje</b>	<b>9</b>
<b>II. Situata e vendit lidhur me trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë – zhvillimet që nga viti 2017</b>	<b>18</b>
Llojet e trafikimit dhe shfrytëzimit, profilet e viktimave (2017-2021)	19
Aspektet gjinore të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë	20
Ndjekjet penale dhe dënimet	24
Ndërgjegjësimi i publikut për trafikimin me qenie njerëzore për shfrytëzim për punë	25
<b>III. Vlerësimi i rrezikut në kontekstin e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë</b>	<b>27</b>
Varfëria si faktor rreziku i trafikimit	27
Tregu i punës	27
Nivelet e punësimit	28
Ekonomia joformale	29
Mungesa e fuqisë punëtore	34
Qasja në tregun e punës për grupet e rrezikuara - Romët	35
Grupet në rrezik trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë	36
Punëtorët migrantë	38
Emigracioni, migrimi i të rinjve dhe migrimi për motive punësimi drejt BE-së	43
Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)	44

---

<b>IV. Përfundime dhe propozime për veprim</b>	<b>46</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>52</b>
<b>SHTOJCA I. Vështrim i përgjithshëm i instrumenteve ndërkombëtare përkatëse</b>	<b>54</b>
<b>SHTOJCA II. Vështrim i përgjithshëm i rastit "Serbaz"</b>	<b>65</b>

# Mirënjohje

Projekti "Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore në Maqedoninë e Veriut" është mirënjohës për konsulentët dhe praktikuesit e mëposhtëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët dhanë kontribut dhe ekspertizë të vlefshme që e mbështetën në masë të madhe përgatitjen e këtij studimi.

**Klara Skrivankova** është një konsulente ndërkombëtare për çështjet e skllavërisë moderne dhe biznesit të përgjegjshëm. Ajo ka punuar për disa organizata të shoqërisë civile si Kundër-Skllavërisë Ndërkombëtare, La Strada dhe Nisma e Tregtisë Etike. Ajo është moderatore, trajnuese dhe autore e publikimeve të shumta.

**Marija Risteska** është themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e think tank Qendrës për Kërkim dhe Politikëbërje. Ajo ka doktoruar në Shkenca Politike nga Universiteti Shën Kirili dhe Metodi në Shkup dhe është Magjistër në Administratën Publike Evropiane dhe Politika Publike nga Katholieke Universiteit Leuven. Është e specializuar për çështjet gjinore.

**Irena Zdravkova** është avokate dhe menaxhere programi në OJQ-në Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj. Ajo është anëtare e ekipit kundër trafikimit dhe ofron ndihmë juridike falas për viktimat e mundshme të trafikimit. Po ashtu, ka njohuri të gjera ligjore dhe përvojë praktike në çështjet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, migracionin dhe azilkërkimin.

**Goran Ristovski** është ekspert i pavarur me përvojë të gjerë kundër trafikimit. Ndër të tjera, ai ai më parë ka punuar si kryeinspektor dhe shef i njësisë për luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore në MPB në Maqedoninë e Veriut.

**Llazar Jovevski** është profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit Shën Kirili dhe Metodi në Shkup. Ekspertiza e tij përfshin legjisllacionin e punës dhe të mirëqenies sociale, ligjet dhe çështjet e politikave në Maqedoninë e Veriut. Ai ka kontribuar në projektet e ONP-së dhe të Këshillit të Evropës.

**Kjmet Amet** është studiuese për përfshirjen e romëve dhe të drejtat e grave. Ajo është menaxhere e programit të OJQ-së Luludi, e cila synon të arrijë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave.

## Lista e shkurtesave

CRPM - Qendra për kërkim dhe politikëbërje

KEDNj - Konventa evropiane për të drejtat e njeriut

BE - Bashkimi Evropian

GRETA - Grupi i ekspertëve të Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit me qenie njerëzore

ONP - Organizata ndërkombëtare e punës

TIK - Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

PSV - Procedurat standarde të veprimit për trajtimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore

UNGPs - Parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut



# I. Hyrje

Ky studim është autorizuar në kuadër të projektit “Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore në Maqedoninë e Veriut” i cili zbatohet në kuadër të programit të përbashkët Bashkimi Evropian - Këshilli i Evropës, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022. Qëllimi i tij është të sigurojë një përditësim mbi tendencat dhe sfidat në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë në Maqedoninë e Veriut, dhe të sqarojë më tej faktorët e rrezikut duke sugjeruar kështu mënyra për parandalimin ose zbutjen e tyre. Raporti i parë për trafikimin me qëllim të shfrytëzimit për punë në Maqedoninë e Veriut u publikua në maj 2017.<sup>1</sup> Ai analizoi kornizën ligjore, politike dhe institucionale, si dhe përpjekjet e ndërmarra nga qeveria, sindikatat, shoqëria civile dhe sektori privat për të trajtuar trafikimin për shfrytëzim për punë.

Që atëherë, zhvillimet dhe tendencat e reja kërkuar kërtime shtesë, të cilat u kryen nga një grup konsulentësh në vitet 2021-2022 dhe çuan në përgatitjen e këtij publikimi. Konsulentët mbledhën të dhëna përmes hulumtimit në zyrë dhe duke bërë kërkesa për informacion tek institucionet. Nuk u mbledhën të dhëna parësore, por informacioni u analizua duke përdorur trekëndëshimin e burimeve dytësore.

Studimi nisët nga supozimi se hartimi i strategjive efektive parandaluese kundër trafikimit kërkon që të kuptohen konteksti më i gjerë social dhe ekonomik dhe të faktorët strukturorë që i bëjnë individët dhe komunitetet të rrezikuar ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Ai njeh nevojën që qeveritë të bëjnë një ndryshim nga qasja e bazuar në pajtueshmëri në qasjen e bazuar në rrezik në zhvillimin e masave kundër trafikimit. Prandaj, baza për zbatimin e këtyre strategjive është vlerësimi i rreziqeve që shkaktojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Përqendrimi i përpjekjeve në këto rreziqe do të përmirësonte identifikimin dhe priorizimin e masave të duhura korrigjuese.

---

<sup>1</sup> Klara Skrivankova, Lazar Jovevski, Raport mbi trafikimin me qëllim shfrytëzimit për punë, 2017; në dispozicion në: <https://rm.coe.int/report-trafficking-in-human-beings-for-labour-exploitation-in-the-form/168073798f>

Ndërsa një metodologji gjithëpërfshirëse për të vlerësuar rreziqet e trafikimit të qenieve njerëzore nuk është zhvilluar deri më sot, studimi synon të ofrojë një pasqyrë të faktorëve strukturorë (siç janë qëndrimet ndaj pakicave etnike, diskriminimi i rrënjosur thellë, tjetërsimi social që çon në privim ekonomik, diskriminim gjinor...) si dhe variablat e përafërta (qasja në tregun e punës, ekonomia joformale, zbatimi i dobët i ligjit, ndërgjegjësimi i ulët midis komuniteteve të rrezikuara dhe publikut të gjerë). Analiza e këtyre faktorëve dhe variablave pritet të kontribuojë në një kuptim më të mirë të shkaqeve themelore të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe të situatave dhe rrethanave që shkaktojnë dobësi.

Një qasje e udhëhequr nga rreziku ndaj veprimit kundër trafikimit u mundëson palëve të interesuara të identifikojnë dhe të veprojnë ndaj rreziqeve të mundshme dhe të përgjigjen duke synuar veprimet në shkaqet themelore. Qasja e kujdesit të duhur të udhëhequr nga rreziku ndihmon në zbulimin e faktorëve të tillë si:

- Rrezikueshmëria individuale/komuniteti që mund të rrisë rrezikun e shfrytëzimit për shkak të karakteristikave të veçanta (p.sh. për shkak të racës, gjinisë, aftësisë së kufizuar, moshës) ose situatave (të jesh migrant, të jesh në varfëri, të jesh i papunë).
- Strukturat dhe sistemet që mund të shkaktojnë shfrytëzim, të tilla si ato që lidhen me tregun e punës dhe operacionet e biznesit (p.sh., praktikat e nënkontraktimit dhe kontraktimit në sektorë të caktuar; mungesa e rregullimit të agjencive të rekrutimit); ekonomia (p.sh., papunësia e lartë ose mungesa e fuqisë punëtore në sektorë të veçantë) ose menaxhimi i migracionit (p.sh. viza të lidhura për kategori të caktuara punëtorësh)

## Konceptet dhe përkufizimet kyçe

Siç theksohet në shënimin udhëzues të grupit të ekspertëve të Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit me qenie njerëzore (GRETA), përkufizimi i pranuar ndërkombëtarisht i trafikimit me qenie njerëzore, i përsëritur në nenin 4 të konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe në instrumente të tjera është një kombinim i tre komponentëve: një "veprim" (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave), i cili kryhet nëpërmjet përdorimit të "mjeteve" (kërcënimi ose përdorimi i forcës ose forma të tjera shtrëngimi, rrëmbimi, mashtrimi, hilja, shpërdorimi i pushtetit ose të një pozicioni të rrezikueshmërisë ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër), me "qëllim" të shfrytëzimit. Përkufizimi ofron një listë të hapur të praktikave të "shfrytëzimit", të cilat përfshijnë shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose shërbime, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve. Pëlqimi i një personi për shfrytëzimin e synuar është i parëndësishëm kur është përdorur ndonjë nga "mjetet" e përmendura më parë, ose kur personi i trafikuar është një fëmijë.<sup>12</sup>


Shënimi udhëzues i GRETA-s theksoi më tej se "trafikimi me qëllim shfrytëzimi për punë si nocion përdoret për të bërë dallimin ndërmjet trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual dhe trafikimit për qëllime shfrytëzuese në sektorë të ndryshëm ekonomikë, si në ekonominë formale ashtu edhe në atë informale. Koncepti i "shfrytëzimit për punë" në kontekstin e trafikimit me qenie njerëzore merret për të mbuluar, së paku, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë dhe robërinë, nocione që njihen mirë në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Veçanërisht, puna e detyruar ose e detyrueshme përkufizohet në nenin 2(1) të Konventës së

<sup>12</sup> GRETA, Упатство за спречување и борба против трговијата со луѓе со цел трудова експлоатација (2020), стр. 4. Достапно на: <http://rm.coe.int/guidance-note-on-preventing-and-combating-trafficking-in-human-beings-/1680a1060c>

Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) në lidhje me punën e detyruar ose të detyrueshme (Nr. 29, 1930) si “çdo punë ose shërbim që kërkohet nga çdo person nën kërcënimin e ndonjë ndëshkimi dhe për të cilin personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht”.<sup>3</sup>

## Vazhdimësia e shfrytëzimit

Koncepti i shfrytëzimit është referuar, por jo i përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare. GRETA thekson se “mungesa e një përkufizimi të qartë të “shfrytëzimit” e bën të vështirë vendosjen e kufirit midis shfrytëzimit për sa i përket shkeljes së të drejtave të punës dhe shfrytëzimit ekstrem që arrin në punë të detyruar. Në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore, ekziston një mbështetje e përgjithshme për të kuptuar “shfrytëzimin” - në kuptimin e përfitimit të padrejtë nga rrezikueshmëria ose gjendja e nevojës së një personi tjetër - si një vazhdimësi,<sup>4</sup> ndonëse e përcaktuar dobët dhe jo statike. Në një rën anë qëndrojnë situata që përbëjnë shkelje të ligjit të punës, të tilla si mospagimi i një page minimale të mandatuar, dhe në ekstremin tjetër janë situatat ku përparësia e padrejtë është e mprehtë dhe dëmi që rezulton është shumë i rëndë. Aktualisht, nuk është e qartë se ku në këtë vazhdimësi shfrytëzimi i punës ndryshon nga konsiderimi si problem i së drejtës së punës në një çështje të ligjit penal.”<sup>5</sup>



**Figura 1: Vazhdimësia e shfrytëzimit**

<sup>3</sup> Po aty., f.4, Shih shtojcën I për një listë të traktateve ndërkombëtare përkatëse.

<sup>4</sup> Klara Skrivankova, Midis punës së denjë dhe punës së detyruar: shqyrtimi i vazhdimësisë së shfrytëzimit, Fondacioni Joseph Rowntree, nëntor 2010.

<sup>5</sup> GRETA, Shënim udhëzues për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të shfrytëzimit për punë, Këshilli i Evropës, fq.5.

## Trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë: një sfidë e madhe në Evropë dhe globalisht

Raportet e GRETA-s tregojnë se trafikimi me qëllim shfrytëzimin për punë ka qenë në rritje në të gjithë Evropën.<sup>6</sup> Ndodh në një sërë sektorësh të ekonomisë, duke përfshirë ndërtimin, mikpritjen, bujqësinë, punët shtëpiake, prodhimtarinë, pastrimin dhe hotelierinë. Ai gjendet si në ekonominë formale ashtu edhe në atë informale dhe ka të bëjë me gratë, burrat dhe fëmijët.

GRETA vuri në dukje se parandalimi dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë është sfidues në shumë aspekte. Një nga barrierat më të mëdha për përpjekjet kundër trafikimit është se akterët kundër këtij të fundit dhe popullsia e përgjithshme nuk e kuptojnë qartë konceptin e trafikimit për motive të punësimit. Ndërgjegjësimi i institucioneve për specifikat e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë ka mbetur për një kohë të gjatë pas ndërgjegjësimit për trafikimin me qëllim të shfrytëzimit seksual. Kjo ka ndikuar në kapacitetin për të identifikuar në mënyrë proaktive situatat e shfrytëzimit për punë. Dallimet në interpretimin dhe zbatimin praktik të standardeve të punës dhe të kuptuarit e shfrytëzimit për punë paraqesin sfida të mëtejshme.<sup>7</sup>

Për të forcuar zbatimin e detyrimit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë, GRETA publikoi një përmbledhje të praktikave të mira në trajtimin e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë dhe një shënim udhëzues për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë (në vijim: shënimi udhëzues i GRETA-s), i cili ofron një përmbledhje të masave që mund të merren nga shtetet palë dhe shpjegon konceptet dhe përkufizimet kryesore.

---

<sup>6</sup> GRETA [Kapitulli tematik mbi trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin për punë në Raportin e 7-të të Përgjithshëm të GRETA-s, 2017.](#)

<sup>7</sup> Po aty.

Raporti i vitit 2017 i përgatitur në kuadër të HF i identifikoi katër fusha që kërkonin vëmendje nga institucionet e Maqedonisë së Veriut:

- Të miratojë kornizën e politikave (rishikimi i planit kombëtar të veprimit dhe strategjisë për të përfshirë Inspektoratin e Punës dhe Agjencinë Shtetërore të Punësimit si akterë me kompetenca në veprimin kundër trafikimit) duke ndjekur parimet udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimin e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Biznesin, dhe të shqyrtojë miratimin e rregulloreve të mëtejshme të agjencive private të punësimit;
- Të sigurojë që Inspektorati i Punës të përfshihet në procedurat standarde të veprimit për trajtimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe të rrisë kapacitetin e këtij të fundit për të kryer hetime proaktive për të identifikuar dhe parandaluar trafikimin në zonat e identifikuar me rrezik;
- Të rris ndërgjegjësimin për rreziqet e trafikimit për shfrytëzimin për punë që lidhen me funksionimin e tregut të punës dhe angazhimin e sindikatave dhe sektorit privat në zhvillimin dhe zbatimin e politikave kundër trafikimit;
- Të nis një projekt pilot për identifikimin proaktiv në një industri në rrezik (siç është bujqësia, tekstili dhe prodhimi i këpucëve dhe lëkurës), me pjesëmarrjen e OJQ-ve, sindikatave, sektorit privat dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive.

Raporti i dytë i vlerësimit të GRETA-s për Maqedoninë e Veriut (2018)<sup>8</sup> rekomandoi, ndër të tjera, që institucionet kombëtare të bëjnë përpjekje për të parandaluar dhe luftuar trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë nga:

- Vazhdimi i ndërgjegjësimit për rreziqet e trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit për punë brenda dhe jashtë vendit;

<sup>8</sup> GRETA, Raport në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit me qenie njerëzore nga "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", 2017, i disponueshëm në internet:

<https://rm.coe.int/greta-2017-39-frg-mkd-en/168078aeba>

- Trajnimi dhe sensibilizimi i zyrtarëve përkatës, veçanërisht inspektorëve të punës, prokurorëve dhe gjyqtarëve, në lidhje me trafikimin me qëllim të shfrytëzimit për punë dhe të drejtat e viktimave;
- Zgjerimi i mandatit të inspektorëve të punës për të mbuluar bizneset dhe shtëpitë private të peregjistruara dhe ofrimi i burimeve dhe udhëzimeve për ta në mënyrë që ata të angazhohen në mënyrë aktive në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore;
- Prezantimi i licencimit dhe monitorimit të agjencive të rekrutimit dhe punës së përkohshme;
- Angazhimi me sektorin privat dhe sindikatat, në përputhje me parimet udhëzuese për biznesin dhe të drejtat e njeriut;
- Rritja e përpjekjeve për identifikimin në mënyrë proaktive të viktimave të trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë duke përfunduar rolin dhe trajnimin e inspektorëve të punës dhe duke i ofruar Inspektoratit të Punës mjetet dhe burimet e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar efektivisht trafikimin;
- Duke i kushtuar vëmendje të shtuar zbulimit të viktimave të mundshme të trafikimit mes migrantëve dhe azilkërkueseve dhe sigurimin e qasjes në interpretim për të lehtësuar procesin.

Në kuadër të projektit "Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore në Maqedoninë e Veriut", janë zhvilluar një sërë aktivitete që nga viti 2017 për të adresuar trafikimin me qëllim të shfrytëzimit për punë. Aktivitetet janë fokusuar në trajnimin e inspektorëve të punës dhe përfshirjen e inspektorëve të punës në PSV-të për identifikimin e viktimave të trafikimit. Rreth 90% e inspektorëve të punës në Maqedoninë e Veriut janë trajnuar për të dalluar shenjat e trafikimit me qenie njerëzore gjatë inspektimeve. Megjithatë, pothuajse gjysma e tyre ishin pensionuar në vitet e kaluara, gjë që e bën të rëndësishme që të sigurohet që inspektorët e punës të sapo rekrutuar të marrin trajnime për këtë temë. Aktivitete të tjera të projektit u fokusuan në ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe të rinjve, në veçanti

dy fushata mbi trafikimin për motive punësimi të zbatuara në bashkëpunim me OJQ-të Porta e Hapur dhe Shoqatën e Gazetarëve për të Drejtat e Njeriut. Kur shqyrtohen faktorët e rrezikut që mund të shkaktojnë trafikimin e punës, sjellja e akterëve të sektorit privat është një nga faktorët që duhet marrë parasysh. Ndërthurja e sjelljes së biznesit dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut po shqyrtohet gjithnjë e më shumë në Evropë dhe globalisht. Për shembull, Komisioni Evropian vuri në dukje se "rrjetet e trafikimit po tregojnë gjithnjë e më shumë nivele profesionalizmi dhe ekspertize, duke e bërë aktivitetin e tyre të duket si një biznes korporativ, shumë më tepër se në të kaluarën. Shtetet anëtare theksuan ekzistencën e sinergjive midis kornizës së politikave kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe politikave publike të miratuara në nivel kombëtar në fusha të ngjashme, si krimi i organizuar, siguria, biznesi dhe të drejtat e njeriut."<sup>9</sup>

Në vitin 2011, u prezantuan parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut (UNGPs), si instrumenti i parë ndërkombëtar jo-detyrues për biznesin dhe të drejtat e njeriut. UNGP-të përmbledhin masat që pritet të marrin shtetet për të mbrojtur njerëzit nga shkelja e të drejtave të njeriut nga palët e treta si bizneset dhe punëdhënësit, si ato të mëdha (si kompanitë shumëkombëshe ose fabrikat e mëdha me furnizues të shumtë) dhe ato të vogla ose të mesme siç janë fermerët individualë që punësojnë një ose dy punëtorë fermash. Këto masa synojnë të parandalojnë një gamë shumë më të gjerë abuzimesh sesa thjeshtë format e shfrytëzimit të lidhura me trafikimin me qenie njerëzore.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup> Komisioni Evropian, [Raporti i tretë mbi progresin e bërë në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore \(2020\) siç kërkohet sipas nenit 20 të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij](#) fq.61.

<sup>10</sup> Mike Dottridge, Këshilli i Evropës 2016, i disponueshëm në internet: [Bashkimi i praktikave të mira nga autoritetet shtetërore, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile në fushën e reduktimit të kërkesës për trafikim njerëzor për shfrytëzimin për punë](#)



Pas prezantimit të UNGP-ve, ka pasur një lëvizje drejt kërkesës së kompanive që të ndërmarrin kujdesin e duhur për të drejtat e njeriut.<sup>11</sup> Në vitin 2021, Parlamenti Evropian miratoi një përmbledhje për një Direktivë të BE-së për të drejtat e detyrueshme të njeriut, mjedisin dhe qeverisjen e mirë. Pritet që BE-ja të miratojë Direktivën në vitin 2022 dhe po e njehta të bëhet ligj në vitin 2023.

Ndërsa trafikimi mund të mos përmendet gjithmonë shprehimisht në këto dokumente, mund të përfundohet se një direktivë e fokusuar në shkeljet e të drejtave të njeriut që i referohet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut synon të mbulojë trafikimin e qenieve njerëzore si një nga shkeljet e të drejtave të njeriut.

Këshilli i Evropës i ka trajtuar gjithashtu këto çështje, duke përfshirë Rezolutën 2311(2019) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Biznesin, pas një Rekomandimi 2166(2016) për të njëjtën temë. Një rekomandim i ri për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë, i cili trajton edhe rolin e sektorit privat, është në proces të miratimit.<sup>12</sup> Për më tepër, si pjesë e platformës së të mësuarit elektronik të programit HELP, Këshilli i Evropës në vitin 2021 vuri në dispozicion një kurs të ri të trajnimit online mbi biznesin dhe të drejtat e njeriut, si dhe një modul të ri për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë, i cili u përfshi në kurset ekzistuese të e-learning mbi të drejtat e punës dhe për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore.

---

<sup>11</sup> Për shembull, Mbretëria e Bashkuar prezantoi aktin e skllavërisë moderne të MB-së (2015) me një klauzolë të transparencës në zinxhirët e furnizimit; Holanda prezantoi ligjin e kujdesit të duhur për punën e fëmijëve, i cili do të hyjë në fuqi në vitin 2022; ndërsa në vitin 2021 Gjermania miratoi një ligj që kërkonte disa kompani që të ndërmarrin kujdesin e duhur për të drejtat e njeriut.

<sup>12</sup> [Draft Rekomandimi](#) i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të shfrytëzimit për punë dhe [Memorandumi shpjegues](#).

## II. Situata e vendit lidhur me trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë – zhvillimet që nga viti 2017

Konteksti socio-politik në Maqedoninë e Veriut ka qenë i turbullt në vitet e fundit dhe kjo është komplikuar më tej nga shpërthimi i pandemisë me KOVID-19.

Treguesit bazë ekonomike tregojnë për pabarazi të mëdha ekonomike, rrogatë ulëta dhe rreziqe të varfërisë, veçanërisht për grupet e marginalizuara:

- Rroga minimale në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 ishte 18.000 denarë (afërsisht 294 euro)<sup>13</sup> që është më e ulët se shumica e vendeve të BE-së dhe niveli i saj nuk mbulon koston bazë të jetesës (shporta minimale e konsumatorit);
- Kostot e banimit janë një barrë financiare për popullsinë me kosto të banimit mbi 50% të të ardhurave të disponueshme familjare në Maqedoninë e Veriut;<sup>14</sup>
- Në vitin 2017, 84.558 individë dhe familje kanë marrë ndihmë sociale;<sup>15</sup>
- Shkalla e varfërisë në Maqedoninë e Veriut për vitin 2018 ishte 17.90%, një rënie prej 1.6% nga viti 2017;<sup>16</sup>
- Angazhimi për zvogëlimin e indeksit të pabarazisë e rradhit Maqedoninë e Veriut në fund në Evropë dhe në vendin e 103-të në listën e 163 vendeve në botë.<sup>17</sup>

<sup>13</sup> Të dhënat e Eurostat-it për vitin 2022, të disponueshme në internet:

[https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum\\_wage\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum_wage_statistics)

<sup>14</sup> Të dhënat e Eurostat-it, të përditësuara për vitin 2017, të disponueshme në internet: <https://www.helgilibrary.com/indicators/population-with-a-housing-cost-burden-over-50-of-disposable-household-income-owner-no-outstanding-mortgage-or-housing-loan/macedonia/>

<sup>15</sup> Enti Shtetëror i Statistikave, e disponueshme në internet:

[Enti Shtetëror i Statistikave - Njoftimet sipas rretheve \(stat.gov.mk\)](http://Enti_Shtetëror_i_Statistikave_-_Njoftimet_sipas_rretheve_(stat.gov.mk))

<sup>16</sup> E disponueshme në internet:

[Shkalla e varfërisë në Maqedoninë e Veriut 2009-2022 | MakroTendencat](#)

<sup>17</sup> E disponueshme në internet: [Indeksi i pabarazisë](#)

## Llojet e trafikimit dhe shfrytëzimit, profilet e viktimave (2017-2021)

Strategjia kombëtare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025)<sup>18</sup> u miratua në prill 2021. Midis 2017 dhe 2020, vetëm tre nga gjithsej 24 viktima të identifikuara të trafikimit me qenie njerëzore ishin viktima të shfrytëzimit për punë. Në të njëjtën kohë, strategjia vë në dukje se institucionet së bashku me OJQ-të identifikuan 345 persona nga kategoritë e rrezikuara në rrezik të lartë trafikimi (viktima të mundshme). Kjo sugjeron se numri real i viktimave të trafikuar për shfrytëzim të punës ka të ngjarë të jetë shumë më i lartë.

**Tabela 1: Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të shfrytëzimit për punë (2017-2021)**

IDENTIFIKUAR	SHFRYTËZIMI PËR PUNË								
	Femra	Meshkuj	Të rritur	Fëmijët	Qytetarët e MV-së	Të huajt	Shfrytëzuar në MV	Shfrytëzuar jashtë vendit	
<b>2017</b>	/	/	/	/	/	/	/	/	
<b>2018</b>	/	/	/	/	/	/	/	/	
<b>2019</b>	1	/	1	/	1	/	1	/	
<b>2020</b>	1	/	1	1	/	1	/	1	
<b>2021</b>	41	6	35	40	1	1	40	41	
<b>Totali</b>	<b>43</b>	<b>6</b>	<b>37</b>	<b>41</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>41</b>	<b>42</b>	

Burimi: Komisioni kombëtar për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore <sup>19</sup>

<sup>18</sup> Strategjia kombëtare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025), e disponueshme në internet:

<http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2021/10/NACIONALNA-STRATEGIJA-MKD-ALB-ANG-25.10.2021.pdf>

<sup>19</sup> Lypja e detyruar nuk përfshihet në tabelë.

Dy viktimat e identifikuara në periudhën 2017-2020 ishin një mashkull i rritur, shtetas maqedonas, si dhe një e mitur, shtetase e huaj.

Numri i viktimave të identifikuara u rrit në vitin 2021, kur institucionet identifikuan 39 viktime (35 burra dhe katër gra) me origjinë nga Tajvani në një rast trafikimi për shfrytëzim të punës që përfshin aktivitete kriminale në internet. Për më tepër, dy shtetas të Maqedonisë së Veriut janë identifikuar edhe si viktime të trafikimit për punë.

Numri i ulët i rasteve të evidentuara të shfrytëzimit për punë tregon se fokusi mbizotërues është ende në forma të tjera, si shfrytëzimi seksual. Për rrjedhojë, shfrytëzimi në punë sezonale bujqësore, apo lypja e detyruar vazhdojnë të jenë të paregjistruara në statistikat zyrtare. Martesat e detyruara janë gjithashtu një problem, zakonisht si një kombinim i shfrytëzimit seksual dhe atij për punë.

## **Aspektet gjinore të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë**

Shoqëria në Maqedoninë e Veriut është ende kryesisht patriarkale. Stereotipet mbizotëruese gjinore përcaktojnë sjelljet dhe pritshmëritë e shoqërisë ndaj grave që të jenë të nënshtruara, të përlura, të kujdesshme për familjen, ndërsa burrat konsiderohen si mbajtësit kryesorë të familjes. Kjo mund të shpjegojë pse gratë në shumicën e rasteve bëhen viktime të trafikimit. Ato kanë më shumë gjasa të jenë në shënjestër sepse sjellja e tyre e pritshme i bën ato viktime më të lehta pasi kanë frikë nga dënimi i shoqërisë nëse e bëjnë publike situatën e tyre.

**Tabela 2: Faktorët e shtytjes dhe tërheqjes, bazat për shfrytëzim**

Faktorët shtytës	Faktorët tërheqës
<p>Varfëria, papunësia, pasiguria sociale, pabarazia gjinore, diskriminimi, familja jofunksionale, konfliktet dhe dhuna, duke përfshirë dhunën në familje konfliktet dhe dhuna, duke përfshirë dhunën në familje</p>	<p>Premtimet për punësim të rregullt, kushte më të mira jetese, por edhe kërkesa për punë dhe shërbime të lira.</p>
<p><b>Bazat për shfrytëzimin e grave</b></p>	<p>Roli i prituri i gruas në shoqëri është të jetë e nënshtruar, e përlulur, të kujdeset për familjen, ndërsa burri të sigurojë familjen financiarisht. Detyrimi për të qenë i nënshtruar dhe i përlulur përfshin gjithashtu një pritje për të pranuar forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, si pjesë e përditshmërisë së saj dhe si faj të saj.</p> <p>Rruga për të dalë nga varfëria dhe/ose nga mjedisi i dhunshëm për një grua shpesh nënkupton kërkimin e mjeteve alternative dhe shpesh të rrezikshme për të siguruar veten, zakonisht jashtë komunitetit të saj lokal. Kjo mund të çojë në trafikim për shfrytëzim seksual ose punë të detyruar.</p>

<p>Bazat për shfrytëzimin e burrave</p>	<p>Roli i pritshëm i një burri në shoqëri është të jetë kryefamiljar, vendimmarrës, por edhe përgjegjës për mirëqenien financiare të familjes. Pamundësia për të siguruar mjete të mjaftueshme çon në kërkimin e burimeve të rrezikshme për punë, të cilat mund të çojnë në punë të detyruar ose forma të tjera trafikimi.</p>
---	--

Mungesa e ndjeshmërisë gjinore dhe nënvlerësimi i diskriminimit me bazë gjinore në punë do të thotë se shumica e *"shfrytëzimit të viktimave, ka të bëjë me shfrytëzimin seksual, i cili më së shpeshti kryhet në ambientet e hotelierisë dhe klubet e natës në pjesën perëndimore të vendit"* sipas strategjisë kombëtare kundër trafikimit,<sup>20</sup> por pa të dhëna për të mbështetur këtë pretendim, pasi rastet mbeten të paidentifikuara, dhe kryerësit nuk ndiqen penalisht.

Gratë dhe vajzat rome konsiderohen më të rrezikuara nga martesat e hershme dhe të detyruara, si dhe nga trafikimi për punë dhe shfrytëzim seksual. Është e rëndësishme që çdo masë kundër trafikimit të marrë parasysh dëmin e dyfishtë me të cilin përballen gratë rome – gjininë dhe përkatësinë e tyre etnike. Kjo i bën ato më të rrezikuara ndaj trafikimit sesa gratë jo-rome.

<sup>20</sup> Strategjia Kombëtare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025), e disponueshme në internet: <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2021/10/NACIONALNA-STRATEGIJA-MKD-ALB-ANG-25.10.2021.pdf>

## Ndjekjet penale dhe dënimet

Prokuroria nuk mban evidencë për rastet sipas llojit të trafikimit. Prandaj është e vështirë të analizohet efektiviteti i procedurave kundër autorëve. Sipas të dhënave të marra nga Prokuroria Publike për krim të organizuar dhe korrupsionit, nga janari 2018 deri më 31 tetor 2021, janë ngritur 10 kallëzime penale për trafikim me qenie njerëzore,<sup>21</sup> ku përfshiheshin 28 persona, 15 prej të cilëve u paditën. Në të njëjtën periudhë 10 kallëzime penale nuk janë shqyrtuar. Tabela e mëposhtme tregon se në vitin 2020, KOVID-19 ndikoi në institucionet ligjzbatuese dhe nuk ka të dhëna për dënimet në këtë periudhë.

**Tabela 3: Rastet e proceduara të trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikimit të fëmijëve (2017-2021)**

Viti	Kallëzime penale	Të dyshuar	Hetimi	Personat e paditur	Personat e dënuar	Heqja dorë nga kallëzimi penal
2017	3	3	2	3	2	2
2018	4	13	6	9	3	8
2019	4	10	9	9	7	2
2020	/	/	/	/	12	/
2021	1	3	/	/	1	/
<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>29</b>	<b>18</b>	<b>21</b>	<b>25</b>	<b>12</b>

*Burimi: Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, nëntor 2021*


Që nga viti 2015 nuk ka pasur asnjë urdhër për mbylljen e një ndërmarrje biznesi/mikpritjeje që është përdorur për kryerjen e një vepre penale trafikimi. As nuk ka pasur ndonjë gjykim për një rast trafikimi për shfrytëzim pune. Për format e tjera të shfrytëzimit, në vitet 2017-2018 janë marrë vendime me më shumë se 10 vjet burgim.<sup>22</sup>

<sup>21</sup> Përgjigje me shkrim nga Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit për kërkesën për qasje në informacione publike, 18.11.2021.

<sup>22</sup> Në vitin 2018, u miratua një vendim ku u shqiptua dënimi më i lartë me burg ndonjëherë për krimin e trafikimit të fëmijëve.

Pas ankesës së Prokurorisë Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, të pandehurit janë dënuar me 17 dhe 14 vjet burg.<sup>23</sup> Në vitin 2021, u miratuan dy aktgjykime, njëri me 12 vjet burgim, ndërsa tjetri me lirim.<sup>24</sup>

**Figura 2: Dënimet dhe ndëshkimet për trafikim njerëzor (2017-2021)**



*Burimi: Gjykata Themelore Penale Shkup për periudhën 01.01.2018-31.10.2021 në bazë të kërkesës për lirinë e qasjes në informata, nëntor 2021*

## Ndërgjegjësimi i publikut për trafikimin me qenie njerëzore për shfrytëzim për punë

Janë ndërmarrë aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese, duke synuar grupet veçanërisht të rrezikuara, si punëtorët migrantë dhe sezonalë, romët dhe personat që mendojnë të punësohen jashtë vendit.

<sup>23</sup> Lazetik dhe Zdravkova, Të drejtat e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore gjatë procesit gjyqësor, 2020 në dispozicion në: <https://rm.coe.int/hf29-research-thb-mkd/16809f035d>

<sup>24</sup> Informata të marra nga Gjykata Themelore Penale Shkup për periudhën 01.01.2018-31.10.2021



Për të rritur ndërgjegjësimin për rrezikueshmërinë e punëtorëve sezonalë ndaj shfrytëzimit për punë, u prodhuan dhe u shpërndanë në media pesë video informative në tri gjuhë (maqedonisht, shqip dhe rome).<sup>25</sup>

Materialet informative për të drejtat e viktimave të trafikimit me genie njerëzore janë prodhuar në gjuhët maqedonase, shqipe, turke dhe rome.

Shoqata e grave dhe të rinjve romë "LULUDI" zhvilloi një fushatë ndërgjegjësimi në pesë qytete, e fokusuar në vajzat rome dhe e prodhuar në gjuhët maqedonase dhe rome<sup>26</sup>

Përveç aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimin, u ndërmorën disa përpjekje për ngritjen e kapaciteteve: (i) përpilimi i një doracakut për punëtorët sezonalë me informacion se si të njohin dhe raportojnë shfrytëzimin për punë;<sup>27</sup> (ii) një udhëzues xhepi për identifikimin e viktimave të trafikimit që është përgatitur dhe dorëzuar tek inspektorët e punës;<sup>28</sup> (iii) inspektorëve të punës u janë ofruar trajnime bazë dhe të avancuara për identifikimin<sup>29</sup> dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit; (iv) trajnime për ekipet e lëvizshme që rifilluan punën aktive në vitin 2021.

Varfëria, papunësia, niveli i ulët arsimor, migrimi dhe mungesa e dokumenteve personale e bëjnë popullatën rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut më të cenueshme ndaj trafikimit. Prandaj, duhet të rritet në mënyrë specifike ndërgjegjësimi për shfrytëzimin e romëve. Fushatat ndërgjegjësuese duhet të kenë në shënjestër të rinjtë romë. Një sondazh i kryer nga OJQ-ja "Luludi" tregoi se 75,19 % e gjimnazistëve të të anketuarve kanë nevojë për një shpjegim të detajuar të formave të trafikimit për

---

<sup>25</sup> Fushata për punë sezonale: <https://www.youtube.com/channel/UCtubQoGuPkk1PgMzEunZ9UQ>, <https://kazistop.mk/>.

<sup>26</sup> Fushata për romët <https://bit.ly/3rb7bd9>, <https://bit.ly/3DOI1nK>

<sup>27</sup> Doracakut për punën sezonale i disponueshëm në internet:

<https://kazistop.mk/wp-content/uploads/2021/04/MZMP-Priracnik-za-sezonski-rabotnici-vnatre-korici-za-web.pdf>

<sup>28</sup> Udhëzues xhepi për inspektorët e punës, i disponueshëm në internet:

<https://rm.coe.int/skopje-pocket-guide-for-detection-and-preliminary-identification-of-vi/1680786ae3>

<sup>29</sup> Trajnimet janë pjesë e projektit Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, përmes projektit Parandalimi dhe Luftimi i Trafikimit me Genie Njerëzore

shfrytëzim për punë, detyrimin për kryerjen e krimeve dhe lypjes së detyruar.<sup>30</sup> Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i të rinjve nuk e perceptojnë punën e detyruar për të shlyer një borxh ose një kredi si një formë të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë. Kjo tregon se skllavëria e borxhit mund të jetë një çështje brenda komunitetit, por mund të mos identifikohet si një formë trafikimi.

Prandaj, nevojiten përpjekje shtesë në fushën e parandalimit për të ndërtuar kapacitete se si të njihet trafikimi për shfrytëzim për punë dhe cilët janë mekanizmat mbrojtës në dispozicion.

---

<sup>30</sup> Analiza e gjetjeve të hulumtimit në lidhje me perceptimet dhe kuptimin e trafikimit me qenie njerëzore midis nxënësve të shkollave të mesme, maj 2021, e disponueshme në internet: <https://bit.ly/30OoZzC>

# III. Vlerësimi i rrezikut në kontekstin e trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë

## Varfëria si faktor rreziku i trafikimit

Të kuptuarit sesi varfëria është një nga shkaqet kryesore të trafikimit me qenie njerëzore për qëllimin nëse shfrytëzimi për punë është i rëndësishëm për krijimin e politikave dhe hartimin e strategjive parandaluese. Grupet e rrezikuara janë më të rrezikuara nga qasja në punë të pasigurta, të cilat mund të çojnë në situata të punës së detyruar dhe shfrytëzimit për punë.

## Tregu i punës

Tregu maqedonas i punës është karakterizuar nga nivele të larta të papunësisë afatgjatë, duke u kthyer në procesin e tranzicionit pas pavarësisë,<sup>31</sup> dhe pasivitetin e lartë tek gratë. Popullsia në plakje rëndon gjithashtu ekonominë dhe projeksionet janë që popullsia në moshë pune (15-64) do të bjerë me 10.2 pikë përqindje në vitin 2050 krahasuar me 2015.<sup>32</sup> Kjo do të thotë se punëdhënësit mund të kenë nevojë të mbështeten gjithnjë e më shumë te punëtorët migrantë.

Pozitivisht, treguesit e fundit të tregut të punës tregojnë një rënie të shkallës së papunësisë tek gratë dhe të rinjtë, pavarësisht efekteve të pandemisë COVID-19. Në vitin 2020, pjesa e të rinjve (15-24) që nuk ishin as në punësim, as në arsim dhe trajnim kishte rënë në 19,4 % për meshkujt dhe 19,8 % për femrat, që është një rënie e ndjeshme krahasuar me shifrat afër 25 % në 2011; megjithatë, norma aktuale është ende pothuajse dyfishi i mesatares së BE-së.<sup>33</sup>

<sup>31</sup> Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, 2017. Zhvillimet në treguesit kryesorë të tregut të punës dhe masat aktive të tregut të punës në trajtimin e papunësisë.


<sup>32</sup> ONP, Programi i vendit për punë të denjë 2019–2022.

<sup>33</sup> Eurostat, 2020. Të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe trajnim sipas gjinisë, moshës dhe statusit të punës (normat NEET).

## Nivelet e punësimit

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore, e matur si përqindje e fuqisë punëtore të popullsisë në moshë pune, po tregon shenja të një përmirësimi të ngadaltë, edhe pse shkalla e lartë e pasivitetit të grave mbetet një shqetësim. Në popullsinë në moshë pune, meshkujt morën pjesë me 77,4 % në grupin e tyre të synuar, ndërsa gratë me 53,6 % në grupin e tyre të synuar në tremujorin e tretë të 2021.<sup>34</sup> Hendeku gjinor në pjesëmarrjen në punë është i pranishëm në të gjitha grupmoshat dhe është ndër më të lartit në Bashkimin Evropian.<sup>35</sup>

**Figura 3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore, hendeu gjinor**




*Burimi: Llogaritjet e vetë autorëve bazuar në të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave dhe Eurostatit, 2021*

Shkalla e punësimit llogaritet si përqindje e përqindjes së të punësuarve ndaj popullatës në moshë pune. Ky tregues gjithashtu tregon një përmirësim të ngadaltë, por ende mbetet dukshëm pas mesatares së BE-së, veçanërisht tek gratë.

<sup>34</sup> Enti Shtetëror i Statistikave, 2021, Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut

<sup>35</sup> Eurostat 2020, i disponueshëm në internet: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement\\_countries\\_-\\_labour\\_market\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_labour_market_statistics)

**Figura 4. Hendeku i normave të punësimit sipas arritjeve arsimore dhe moshës**



*Burimi: Llogaritjet e vetë autorëve bazuar në të dhënat nga Eurostat (Baza e të dhënave e Eurostat, 2022)*


Kur kontrollohet për moshën, hendeku i shkallës së punësimit ndryshon midis nëngrupeve të arritjeve arsimore. Në grupmoshat 25-54 dhe 55-64 vjeç hendeku i shkallës së punësimit është më i lartë tek ata me nivel të ulët arsimor dhe më i ulëti tek ata me nivele më të larta arsimore. Krahasuar me këto grupmosha, shkalla e punësimit tek të rinjtë (15-24 vjeç) tregon lëvizje të ndryshme. Hendeku është i lartë për ata me nivele mesatare të arritjeve arsimore.

## Ekonomia joformale

Punonjësit joformalë dihet se janë në rrezik më të lartë të shfrytëzimit. Prandaj është e rëndësishme të monitorohen dhe analizohen të dhënat në lidhje me punën joformale.

Figura 5 tregon se numri i punëtorëve joformalë ka qenë në rënie si për burrat ashtu edhe për gratë. Kështu, krahasuar me vitin 2018 këto shifra kanë rënë me 21,271 ose 22,42 % për burrat dhe 11,788 ose 25,66 % për gratë për të gjithë popullsinë në moshë pune (15).


## Слика 5. Неформалност (15+) според полот



*Burimi: Punonjësit joformalë sipas moshës dhe gjinisë, (Enti Shtetëror i Statistikave, 2021)*

Пërqindja e punësimit joformal ndaj punësimit total për të gjithë popullsinë në moshë pune (15+) po shfaq prirje rënëse në periudhën 2018-2020, si për femrat ashtu edhe për meshkujt.


## Figura 6. Përqindja e numrit të përgjithshëm të punësimit joformal 15+ vjeç



*Burimi: Llogaritjet e vetë redaktorit bazuar në punonjësit joformalë sipas të dhënave gjinore (Enti Shtetëror i Statistikave, 2021)*

Figura 7 paraqet numrin e njerëzve që punojnë në sektorin joformal të ndarë sipas gjinisë dhe arritjeve arsimore. Shumica e burrave dhe grave të angazhuar në punësim joformal kanë arsim fillor dhe të mesëm. Numrat janë të qëndrueshëm përgjatë viteve si për burrat ashtu edhe për gratë, por ka disa ndryshime të dukshme në të dy skajet e shkallës arsimore. Gjegjësisht, numri i punëtorëve joformale femra pa arsim pothuajse u dyfishua në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Nga spektri tjetër, numri i meshkujve me arsim universitar që punojnë joformalisht u rrit me 12% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, ndërsa në të njëjtën periudhë numri i femrave punonjëse joformale me arsim universitar u ul me 35%.

**Figura 7. Informaliteti sipas arsimit (2017-2019)**




*Burimi: Punësimi joformal sipas arritjeve arsimore dhe gjinisë, (Enti Shtetëror i Statistikave, 2019 dhe 2021)*

## Ndikimi i KOVID-19 në tregun e punës

Shkalla e papunësisë ka vazhduar të bjerë gjatë pandemisë KOVID-19. Pas tremujorit të dytë të vitit 2020, norma vazhdoi të bjerë për gratë dhe nuk u rrit për burrat. Megjithatë, kjo është pjesërisht për shkak të zhvendosjes së grave në sektorin e shërbimeve dhe rënies së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.<sup>36</sup> Kështu, shkalla e papunësisë së grave arriti një nivel të ulët rekord në tremujorin e tretë të 2021 në 14.7%, ndërsa shkalla e burrave ngeci në 16.6%.

**Figura 8. Shkalla e papunësisë sipas gjinisë**



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, 2021


Pas krizës që lidhet me goditjen e pandemisë KOVID-19, si burrat ashtu edhe gratë janë larguar nga tregu i punës në numër më të madh: në tremujorin e tretë të vitit Shtetëror i Statistikave regjistroi 3,25% më shumë burra që u larguan nga tregu i punës në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2020, ndërsa për femrat ky ndryshim është 2,35%. Në shifra absolute kjo përkthehet në gjithsej 19,250 njerëz që hoqën dorë nga kërkimi për punë (10,594 gra dhe 8,656 burra).

<sup>36</sup> Banka Botërore, 2021, Gjelbërimi i Rimëkëmbjes, Ballkani Perëndimor nr. 20, në dispozicion në internet:

[Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor, Nr. 20, Vjeshtë 2021: Gjelbërimi i Rimëkëmbjes \(worldbank.org\)](#)



**Figura 9. Popullsia joaktive, vlerat absolute**



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, 2021

Pandemia e KOVID-19 ndikoi kryesisht punëtorët me pagë të ulët, punëtorët në ekonominë joformale, punëtorët shtëpiak me pagesë dhe punëtorët e papaguar të familjes. Analiza e tërthortë e punës së pasigurtë "...sugjeron që humbja totale e vendeve të punës gjatë pandemisë prej rreth 7.500 në nivel vjetor ka qenë kryesisht midis punëtorëve me rrogë të ulët, nga të cilët një pjesë e madhe janë punëtorët shtëpiak me pagesë dhe punëtorët joformalë."<sup>37</sup>

Pandemia ka ndikuar ndryshe në punë për burrat dhe gratë. Kështu, midis tremujorit të katërt të 2020-ës dhe tremujorit të parë të 2021-ës, shumica e humbjeve të vendeve të punës të grave ishin në sektorët e akomodimit dhe hotelierisë (5500), pasuar nga prodhimi (4100), bujqësia (3800) dhe tregtia (3500). Burrat humbën shumicën e vendeve të punës në sektorët e agjencive të udhëtimit (3600), minierave (3200) dhe bujqësisë (2800).

Paga minimale neto u rrit nga 12.000 denarë (rreth 196 euro) në vitin 2017, në 15.194 denarë (afërsisht 236 euro) në vitin 2021 dhe në 18.000 denarë (rreth 294 euro)<sup>38</sup> në vitin 2022.

<sup>37</sup> Finance Think, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, Studimi i Politikave Nr. 36, EFEKTI I KOVID-19 NË PUNËTORËT E PASIGURT NË MAQEDONINË E VERIUT, ndjekja e punëtorëve me paga të ulëta, punëtorëve të papaguar të familjes, punëtorëve shtëpiak me pagesë, punëtorëve me kontrata pune atipike dhe punëtorëve informalë, 2021, fq. 59.

<sup>38</sup> Të dhënat e Eurostat-it për vitin 2022, të disponueshme në internet: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum\\_wage\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Minimum_wage_statistics)

## Mungesa e fuqisë punëtore

Luhatjet e tregut të punës në periudhën 2017-2020 janë kryesisht për shkak të daljes së fuqisë punëtore në BE dhe politikës arsimore që nuk i plotëson nevojat e tregut. Pandemia e KOVID-19 uli intensitetin e daljeve të fuqisë punëtore.<sup>39</sup> Në disa sektorë, pavarësisht shkallës së lartë të papunësisë, ka mungesë të punëtorëve. Sektori i ndërtimit ka përjetuar një mungesë afatgjate të punëtorëve dhe ka një praktikë të punësimit të punëtorëve migrantë nga Shqipëria dhe Turqia. Studimi i Qendrës për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) mbi punëtorët sezonalë në bujqësi zbuloi se punëdhënësit në sektorin e bujqësisë gjithashtu përballen me mungesa serioze të fuqisë punëtore. Pandemia e KOVID-19 ndikoi ndjeshëm në disponueshmërinë e personelit mjekësor në spitale, kryesisht për shkak të largimit të tyre drejt vendeve të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Zvicrës. Profesione të tjera me mungesë përfshijnë saldatorë, bravandreqës, kamerierë, operatorë makinerish dhe profesione në fushën e informacionit dhe teknologjisë.<sup>40</sup>

Aty ku mungesat e fuqisë punëtore plotësohen nga punëtorë migrantë, është e rëndësishme që politikat e tregut të punës dhe të migracionit për motive punësimi të përfshijnë masa mbrojtëse kundër shfrytëzimit

---

<sup>39</sup> Studimi i politikës CRPM 39: Nga hija te punëtori sezonal i dukshëm në bujqësi: arsyet, sfidat dhe modelet për formalizimin e punës sezonale në sektorin e bujqësisë, 2020, në dispozicion në internet: [http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/CRPM\\_od\\_senka\\_vo\\_vidliv\\_sezonski\\_rabotnik\\_final-eng-cikp.pdf](http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/CRPM_od_senka_vo_vidliv_sezonski_rabotnik_final-eng-cikp.pdf)

<sup>40</sup> Të dhënat për mungesën e fuqisë punëtore sipas profesioneve janë mbledhur në bazë të shpalljeve për poste të publikuara në katër vitet e fundit nga Agjencia për Punësim e Maqedonisë së Veriut.

## Qasja në tregun e punës për grupet e rrezikuara - Romët

Në Maqedoninë e Veriut, shkalla e papunësisë së njerëzve nga komunitetet rome është 33%, krahasuar me 16% të jo-romëve.<sup>41</sup> Të dhënat e Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut tregojnë se deri në tetor 2021 në vend janë regjistruar gjithsej 134.219 persona të papunë, prej të cilëve 13.644 romë (afërsisht 10% e numrit të përgjithshëm të personave të papunë).<sup>42</sup> Megjithatë, ky numër është ndoshta më i lartë, duke qenë se një numër i personave romë janë të paregjistruar në lindje dhe nuk kanë dokumente personale. Në prill të vitit 2021 kishte 659 persona pa certifikatë lindjeje, 60% e të cilëve janë fëmijë, kryesisht romë (428).<sup>43</sup>

**Tabela 4: Të papunët e regjistruar në mesin e romëve sipas gjinisë 2017-2021**

Pasqyrë e personave të papunë të regjistruar		31.10.2021	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2018	31.12.2017
Romë	të gjithë	13,644	14,396	9,239	6,321	6,127
	gra	6,986	7,280	4,632	2,715	2,366
Nr total. i të papunëve		134,219	156,432	101,748	94,721	102,394

*Burimi: Agjencia e punësimit*

Romët e kanë të vështirë të hyjnë në tregun e punës pavarësisht nga masat e mbështetura nga shteti që i kanë në shënjestër ata. Barriera kryesore për punësim është arsimi i ulët i shoqëruar nga diskriminimi. Shkalla e punësimit për romët është 22 %,


<sup>41</sup> Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MAKStat, 2021.

<sup>42</sup> Agjencia për Punësim, Statistikat e Punësimit, Shkup: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2021, në dispozicion në internet: <https://av.gov.mk/pregled-na-evidentirani-nevraboteni-lica.nspix>

<sup>43</sup> Avokati i Popullit i Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në internet: <https://bit.ly/3nzFokd>

ndërsa ajo e jo-romëve është dyfish. Në vitin 2017 vetëm 1% e numrit të përgjithshëm të përdoruesve të masave për punësim ishin romë (vetëpunësim, mbështetje për pozicione të reja pune dhe angazhim në punë). Edhe pse ka një rritje të romëve që përfitojnë nga masat e punësimit, numri i tyre është 10 herë më i vogël në krahasim me etnitë e tjera.

**Figura 10: Gratë dhe burrat romë si përqindje e totalit të të papunëve (2017-2021)**



Burimi: Agjencia e shërbimit të punësimit

## Grupet në rrezik trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë

Grupe të caktuara të popullsisë janë në një rrezik më të madh, pasi rrezikueshmëria ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit përcaktohet nga një kombinim faktorësh, shumica e të cilëve janë strukturorë dhe të lidhur me politikat sociale, ekonomike, të punës dhe të imigracionit. Rrezikueshmëria personale përkeqësohet kur njerëzit janë të izoluar - qoftë fizikisht apo social - dhe nuk organizohen apo avokojnë kolektivisht. Punëtorët migrantë, azilkërkuesit, pakicat etnike të pafavorizuara dhe të rinjtë janë veçanërisht të rrezikuar ndaj trafikimit për shfrytëzim pune.

Faktorë të veçantë të cilët çojnë në rritjen e cenueshmërisë:

- **Personat me status të pasigurtë të migrimit** të cilët janë të akomoduar në qendrat e pritjes janë veçanërisht të rrezikuar, si dhe **azilkërkuesit** të cilët ende nuk kanë

status të rregulluar. Azilkërkuesit nga kriza e refugjatëve në Kosovë<sup>44</sup> në vitin 1999, statusi i të cilëve nuk është rregulluar ende pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe që nuk kanë qasje në arsim, kujdes shëndetësor dhe llogari bankare, janë gjithashtu shumë të rrezikuar.<sup>45</sup>

- ***Punëtorët migrantë*** nevojiten gjithnjë e më shumë për të plotësuar mungesat e fuqisë punëtore në vend. Megjithatë, pa gjuhën, njohuritë për të drejtat e tyre, mungesën e rrjeteve sociale dhe shpesh statusin e pasigurt, këta punëtorë janë në rrezik të shtuar të shfrytëzimit të punës.
- ***Shtetasit e Maqedonisë që migrojnë për punë jashtë vendit*** të cilët kanë status të parregulluar në vendet e destinacionit ose në disa raste, punojnë në kundërshtim merregulloret, janë veçanërisht të rrezikuar.

Rrezikueshmëria e komunitetit *rom* ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore rrjedh nga një sërë faktorësh të ndërlikur.<sup>46</sup> Vlerësohet se 80% e fëmijëve që punojnë ose jetojnë në rrugë janë nga komuniteti rom.<sup>47</sup> Qendrat ditore për fëmijët e rrugës nuk e kanë ulur numrin e fëmijëve që detyrohen të lypin, duke sugjeruar se këto programe janë të pamjaftueshme për të luftuar punën e fëmijëve.<sup>48</sup> Dokumenti kryesor i politikave<sup>49</sup> ishte në fuqi deri në vitin 2015 dhe nuk ka informacion për ndonjë përpjekje të ripërtërirë.

---

<sup>44</sup>\* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

<sup>45</sup> Sipas llogaritjeve 343 persona, mbeten në një situatë të pasigurtë, dhe me status të pasigurtë. Me përjashtim të një numri të kufizuar (16) refugjatësh të njohur, pjesa tjetër kanë ose mbrojtje plotësuese (198) ose nuk kanë status (129).

<sup>46</sup> Kontributi kombëtar Franet në Raportin e të Drejtave Themelore 2020, i disponueshëm në internet:

[https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/north-macedonia-frr2020\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/north-macedonia-frr2020_en.pdf)

<sup>47</sup> Sipas një ankete të Zyrës së Avokatit të Popullit të publikuar në vitin 2018, gjithsej 337 fëmijë lypës janë regjistruar në rrugë, ku vetëm nëntë prej të cilëve nuk ishin të përkatësisë etnike rome.

<sup>48</sup> Gjetjet e vitit 2020 mbi format më të këqija të punës së fëmijëve: Maqedonia e Veriut, [https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child\\_labor\\_reports/tda2020/North-Macedonia.pdf](https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child_labor_reports/tda2020/North-Macedonia.pdf)

<sup>49</sup> Plan i veprimit për fëmijët në situatë rruge (2013-2015).

- Shumë *fëmijë të pashoqëruar* janë identifikuar ende në vend dhe ata janë të pambrojtur ndaj trafikimit.
- Fëmijët dhe të rinjtë të cilët kanë qenë në konflikt me ligjin, kanë një histori ikje nga shtëpia, nuk kanë një rrjet social mbështetës dhe kanë vetëbesim të ulët ose aftësi të kufizuara fizike ose mendore, janë gjithashtu të rrezikuar.

## Punëtorët migrantë

Maqedonia e Veriut është kryesisht një vend tranzit për migrantët dhe refugjatët. Shumë prej tyre vazhdojnë të kalojnë nëpër territor ose të qëndrojnë për një kohë, duke pritur mundësinë e radhës për të shkuar më tej në BE. Vetëm një numër i vogël aplikon për azil. Migrimi shkon në dy drejtime: (i) nga Greqia në Evropën Perëndimore, dhe (ii) një numër më i vogël i migrantëve që nuk arritën në BE nga Serbia dhe vendet e tjera të Ballkanit kthehen në Greqi përmes territorit të Maqedonisë së Veriut. Shifrat e sakta nuk janë të disponueshme pasi shumë migrantë nuk janë të regjistruar. Mbrojtja adekuate dhe qasja në procedurën e azilit të grupeve të cënueshme është ende një sfidë veçanërisht për fëmijët e pashoqëruar.

Në periudhën 2017-2021 është rritur numri i migrantëve dhe në vitin 2019 është regjistruar një numër rekord i kërkesave për azil. Shumica dërrmuese e aplikimeve bëhen nga meshkujt. Në vitin 2021, ka pasur një rënie prej 57% të ardhjeve të reja në krahasim me vitin 2020. Në vitin 2021, 10% (119) e aplikimeve janë dorëzuar nga gra (18 ) dhe 17% (198) nga fëmijë, duke përfshirë 37 fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë.<sup>50</sup>

<sup>50</sup> RBE - Ballkani Perëndimor - Statistikat e azilit - Përmbledhje e tendencave kryesore të vëzhguara që nga 1 tetori 2021.

**Tabela 5: Numri i migrantëve dhe azilkërkuesve (2017-2021) sipas gjinisë dhe kategorisë së fëmijëve migrantë**

Viti	Numri i përgjithshëm i ardhjeve të reja të emigrantëve	Numri i azilkërkuesve	Azilkërkues meshkuj	Fëmijët azilkërkues	Fëmijë të pashoqëruar azilkërkues
2017 <sup>51</sup>	17,000	162	145	28	13
2018 <sup>52</sup>	32,500	297	211	78	41
2019 <sup>53</sup>	40,887	505	465	132	94
2020 <sup>54</sup>	41,257	187	157	30	19
2021 <sup>55</sup>	17,644	95	62	23	14

*Burimi: RBE dhe MYLA, 2018-2021*

Vendet e origjinës së emigrantëve dhe refugjatëve që kalojnë tranzit përmes Maqedonisë së Veriut përfshijnë Pakistanin, Irakun, Afganistanin, Turqinë dhe Kongon. Në fund të vitit 2021 u vu re një tendencë e re, me rritjen e numrit të emigrantëve nga Afganistani dhe Siria.<sup>56</sup>

<sup>51</sup> Databaza e MYLA-s,:

<https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/01/2017-CSOs-Report-on-Irregular-Migration-for-South-Eastern-Europe.pdf>

<sup>52</sup> Raporti MYLA,

<https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/Sostojba-so-azil-RSM-2018-2019.pdf>


<sup>53</sup> Po aty.

<sup>54</sup> Ballkani Perëndimor - Refugjatët, azilkërkuesit dhe njerëzit e tjerë në lëvizje të përziera, deri në fund të tetorit 2021.

<sup>55</sup> RBE - Ballkani Perëndimor - Statistikat e azilit - Përmbledhje e tendencave kryesore të vëzhguara që nga 1 tetori 2021.

<sup>56</sup> Ballkani Perëndimor - Refugjatët, azilkërkuesit dhe njerëzit e tjerë në lëvizje të përziera, nga fundi i tetorit 2021, faqe 2 për Maqedoninë e Veriut.

## Figura 11: Flukset mujore të migracionit (2018-2021)



*Burimi: RBE - Ballkani Perëndimor - Statistikat e azilit - përmbledhje e tendencave kryesore të vëzhguara që nga 1 tetori 2021.*

Strategjia kombëtare për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore identifikon baret dhe restorantet në pjesën perëndimore të vendit si vendet më të zakonshme për shfrytëzimin e viktimave. Edhe pse ka bastisje dhe kontrole policore, asnjë prej tyre deri më tani nuk ka rezultuar me dënime për shfrytëzim për punë, por vetëm në procedime kundërvajtëse ndaj grave migrante që punojnë ilegalisht si këngëtare, valltare apo kamariere dhe me dëbimin e tyre apo ndalimin e hyrjes në vend. Nuk u ngrit asnjë kallëzim penal ndaj pronarëve të bareve dhe restoranteve për përfshirje në trafikimin me qenie njerëzore dhe shfrytëzimin për punë.

## Tabela 6: Bastisjet e policisë dhe zbulimi i shtetasve të huaj (2017-2020)

Viti	Numri i bastisjeve të policisë	Numri i bareve/ restoranteve	Zbulimi i shtetasve të huaj	Zbulimi i shtetasve maqedonas
2017	28	16	119	67
2018	/	/	/	/
2019	45	68	204	/
2020	24	/	124	/

*Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme*



Numri i punëtorëve migrantë të parregullt në sektorin e ndërtimit ka qenë gjithashtu në rritje sipas policisë dhe inspektimit të punës. Për shkak të mungesës së fuqisë punëtore në këtë sektor, kompanitë e huaja të ndërtimit po sjellin punëtorë nga Turqia, Shqipëria dhe Kosova\*.<sup>57</sup> Në janar 2022, u raportua një rast i 97 punëtorëve të huaj të ndërtimit që punonin për një kompani turke.<sup>58</sup> Ata u arrestuan për punë të paligjshme dhe policia bëri me dije se do të ngrihej kallëzim penal ndaj kompanisë dhe nënkontraktorëve të saj.

Për më tepër, inspektimet e punës kanë gjetur emigrantë nga Siria, Pakistani, Irani, Bangladeshi dhe Maroku, të cilët ishin përfshirë në punë joformale gjatë tranzitit nëpër vend. Asnjë nga rastet nuk ka rezultuar me dënime për shfrytëzim për punë, por me procedime kundërvajtëse ndaj shtetasve të huaj, gjoba dhe dëbim.

Duket se fokusi është në statusin e punëtorëve në vend, sesa në kushtet e punësimit dhe rekrutimit të tyre. Do të ishte e rëndësishme të sigurohet që çdo rast i një punëtori të parregullt të trajtohet si një situatë e mundshme trafikimi dhe punëtorët duhet të kenë mundësinë t'i përshkruajnë një pale të tretë të pavarur se si erdhën në vend dhe cilat ishin kushtet e tyre të punësimit.

---

<sup>57</sup> \*Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

<sup>58</sup> <https://civilmedia.mk/politsijata-privede-rechisi-100-stranski-rabotnitsi-na-gradilishte-vo-skopje/>

**Tabela 7: Numri i shtetasve të huaj që punojnë në mënyrë të parregullt në ndërtim**

Viti	Numri i shtetasve të huaj të zbuluar që punojnë në mënyrë të parregullt në ndërtim
2018 год. <sup>59</sup>	61
2019 год. <sup>60</sup>	94
2020 год. <sup>61</sup>	91
2021 год. <sup>62</sup>	97

Një tendencë tjetër vërehet te romët pa dokumenta (kryesisht maqedonas, por edhe disa që vijnë nga Kosova\*<sup>63</sup> dhe Shqipëria) të cilët janë të angazhuar si punëtorë sezonalë në bujqësi. Një studim i fundit tregoi se në qytetet e Vinicës dhe Koçanit, 40% e banorëve romë janë të papunë dhe angazhohen rregullisht në punë sezonale. 48% e fëmijëve romë që janë punëtorë sezonalë nuk ndjekin fare shkollën dhe 52% e mbetur vijoje shkollën në mënyrë të parregullt në maj, qershor, shtator dhe tetor.<sup>64</sup>

<sup>59</sup> <https://netpress.com.mk/stranski-gradezhni-kompanii-nosat-rabotnici-od-albani-a-i-od-kosovo-da-rabotat-na-crno/>

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> <https://bit.ly/3r1Szw9>

<sup>62</sup> <https://sdk.mk/index.php/makedonija/od-97-te-ilegalni-zidari-privedeni-na-gradilishteto-na-limak-94-bile-od-turtsija-trojtsa-od-albanija-sudot-pochna-da-gi-proteruva/>

<sup>63</sup> \*Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

<sup>64</sup> Iniciativa e Shoqatës së Intelektualëve të Papunë, analizë e hulumtimit të kryer për arsyet e mungesës nga procesi arsimor i nxënësve romë nga Vinica dhe Koçani për shkak të punës sezonale, 2019.

## Emigracioni, migrimi i të rinjve dhe migrimi për motive punësimi drejt BE-së

Emigrimi ka qenë traditë në Maqedoninë e Veriut, por mund të vërehen disa ndryshime. Ndërsa në shekullin e kaluar njerëzit emigronin për arsye socio-ekonomike (kryesisht persona të privuar ekonomikisht dhe persona më pak të arsimuar), në shekullin e 21-të janë qytetarët e rinj, të arsimuar mirë dhe të siguruar financiarisht ata që kërkojnë stabilitet politik dhe cilësi më të mirë të jetës në vendet e zhvilluara. Pothuajse 30% e personave me arsim të lartë jetojnë dhe punojnë jashtë vendit dhe pothuajse 80% e studentëve në vitet e fundit të studimeve në fakultetet teknike mendojnë ose planifikojnë të largohen nga vendi.<sup>65</sup> Kjo krijon presion në tregun e punës pasi numri i punëkërkuesve aktivë në moshë është në rënie. Të dhënat e fuqisë punëtore 2019 dhe 2020 tregojnë se numri i personave të moshës 15 deri në 24 vjeç është ulur me 5,387, dhe ata të moshës 25 deri në 49 vjeç me 12,402.


Sipas Entit Shtetëror të Statistikave në periudhën 2017-2020, 2681 qytetarë të Maqedonisë së Veriut emigruan (kryesisht në vendet e BE-së, si dhe në Zvicër, SHBA, Kanada dhe Australi), shumica e tyre me arsim të mesëm (55%).<sup>66</sup>

---

<sup>65</sup> Strategjia kombëtare për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e daljeve të stafit me arsim të lartë dhe profesional (2013-2020).

<sup>66</sup> [http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_Naselenie\\_NadvoresniMigracii/176\\_Migracii\\_drzavi\\_VkDosOts\\_mk.px/?rxid=e1061203-a84f-4559-92af-4098566d7d2f](http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_Naselenie_NadvoresniMigracii/176_Migracii_drzavi_VkDosOts_mk.px/?rxid=e1061203-a84f-4559-92af-4098566d7d2f)

**Figura 12: Migrimi i jashtëm, vendet e destinacionit (2017-2021)**



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, 2021

Sipas të dhënave të Eurostat-it për lejet e qëndrimit, 84.291 qytetarë të Maqedonisë së Veriut kanë marrë leje qëndrimi në vitet 2017-2020, nga të cilat 35% për qëllime pune.

Sipas të dhënave të Eurostat-it, gjithsej 3,805 qytetarë të Maqedonisë së Veriut janë kthyer nga BE-ja në vitet 2017-2020; 1,670 prej tyre ishin të kthyer jo vullnetarë në përputhje me marrëveshjet e ripranimit dhe 2,060 u kthyen vullnetarisht.<sup>67</sup>

## Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

Duke qenë se trafikimi organizohet shpesh në internet, përdorimi i kanaleve të koduara të komunikimit dhe platformave të mediave sociale krijojnë më shumë sfida për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë. Kjo është veçanërisht problematike pasi të gjitha operacionet e fundit të trafikimit kanë komponentë në internet. Megjithatë, agjencitë e zbatimit të ligjit janë më pak të shkathëta kur bëhet fjalë për monitorimin e zhvillimeve teknologjike dhe reagimin e menjëhershëm. Në të njëjtën kohë, mediat sociale dhe kanalet

<sup>67</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/MIGR\\_EIRT\\_VOL\\_custom\\_1713238/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/MIGR_EIRT_VOL_custom_1713238/default/table?lang=en)

e rrjeteve sociale mund të përdoren për të arritur grupet e rrezikuara me informacion në lidhje me të drejtat e tyre dhe qasjen në mbështetje dhe këshilla.

Rekrutimi i viktimave të trafikimit bëhet gjithnjë e më shumë nëpërmjet internetit nëpërmjet njoftimeve në dukje tërheqëse për punësim, udhëtime, martesë me të huaj apo faqe interneti për takime. Shumica e viktimave janë të moshës 13-17 vjeç, ku shumica e viktimave (raportohet deri në 90%) i përkasin komunitetit rom.<sup>68</sup> Situata socio-ekonomike pas krizës së KOVID-19 dhe mungesa e informacionit për treguesit e trafikimit janë faktorë që i bëjnë romët të rrezikuar ndaj trafikimit.

Rreziqet e shfrytëzimit për punë të migrantëve rriten pasi kontrabandistët po përdorin

Rezikueshmërinë= e migrantëve dhe gatishmërinë e tyre të dukshme për të pranuar çdo lloj mundësie pune për të fituar disa të ardhura. Gjithnjë e më shumë zgjidhje digjitale përdoren në këtë proces. Edhe mënyrat e pagesës kanë ndryshuar dhe janë transferuar në kriptovaluta, gjë që ka rezultuar me përfshirjen e personave të arsimuar dhe personave me aftësi të teknologjisë së lartë në trafikim për qëllime të shfrytëzimit për punë. Puna në internet është veçanërisht e pasigurtë duke privuar punonjësit nga qasja në sigurimin shëndetësor dhe pensional, si dhe duke kontribuar në evazionin fiskal.

---

<sup>68</sup> Fushata ndërgjegjësuere e Open Gate/La Strada "Mundësi ose Shfrytëzim" Mundësi ose Shfrytëzim - La Strada (lastrada.org.mk).

## IV. Përfundime dhe propozime për veprim

Numri i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë në Maqedoninë e Veriut është mjaft i ulët, me përjashtim të vitit 2021 kur 39 shtetas të huaj u zbuluan në një rast të trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë përmes mashtrimit në internet.<sup>69</sup> Strategjia për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore vëren se numri i viktimave të identifikuara të trafikimit për shfrytëzim për punë është "i parëndësishëm dhe kufizon aftësinë për identifikimin e sektorëve dhe grupeve të rrezikut".<sup>70</sup> Në anën tjetër, numri i viktimave të mundshme është dukshëm më i lartë; megjithatë, nuk ka të dhëna të disponueshme për kombësinë e tyre, llojin e shfrytëzimit dhe karakteristikat e tjera. Arsyet për dallimin ndërmjet numrit të ulët të viktimave të identifikuara zyrtarisht dhe numrit dukshëm më të madh të viktimave të mundshme janë të shumfishta dhe lidhen me dobësinë institucionale dhe mungesën e burimeve. Deklaratat e viktimave janë prova kryesore në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë. Organeve ligjzbatuese u mungojnë kapacitetet teknike, njerëzore dhe institucionale për të mbledhur prova nëpërmjet përdorimit të TIK-ut, informacionit me burim të hapur dhe rrjetit të errët ku trafikantët zakonisht shkëmbejnë informacione dhe planifikojnë veprimet e tyre.

Sipas vlerësimit të rrezikut të krimit të rëndë dhe të organizuar të Europolit 2021, viktimat e trafikimit zakonisht shfrytëzohen si

---

<sup>69</sup> Rasti në fjalë kishte të bënte me 39 persona (35 burra dhe katër gra) të cilët ishin rekrutuar në Tajvan dhe mbërritën në Maqedoninë e Veriut me viza turistike. Ata u mbyllën në një shtëpi, iu morën dokumentet e udhëtimit dhe celularët dhe u detyruan të bënin thirrje mashtruese me njerëzit në Kinë, duke pretenduar se janë zyrtarë sigurimesh, bankash, postare ose policie, duke kërkuar të dhënat e tyre bankare dhe duke tërhequr para. Pas marrjes së një informate nga institucionet tajvaneze në nëntor 2020, autoritetet e Maqedonisë së Veriut hetuan rastin dhe në maj 2021 arrestuan nëntë të dyshuar dhe identifikuan 39 persona si viktimat e qenieve njerëzore. Viktimat dhe të dyshuarit u kthyen në Tajvan një muaj më vonë.

<sup>70</sup> Komisioni kombëtar për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit të paligjshëm, strategjia për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (2021-2025).

punëtorë me kualifikim të ulët, sezonal dhe me kosto të ulët në transport, ndërtim, bujqësi, pylltari, përpunimin e ushqimit, linjat e montimit të fabrikave, furnizim ushqimi, shitje me pakicë, lavazh makinash, bukuri dhe pastrim, punë shtëpie dhe ndihmë në shtëpi.<sup>71</sup>

Duke qenë se numri i viktimave të identifikuar të trafikimit me genie njerëzore për shfrytëzim për punë në Maqedoninë e Veriut mbetet i ulët, nuk është e mundur të kryhet një analizë e bazuar në raste për të identifikuar sektorët e rrezikut. Në vend të kësaj, studimi duhet të fokusohet në sektorë që janë të rregulluar dobët, kanë mungesë të fuqisë punëtore dhe ku mbizotërojnë punëtorët e rrezikuar dhe ekonomia joformale, përkatësisht: (i) ndërtim, (ii) tekstil, (iii) industrinë e këpucëve, (iv) hotelieri (klube të natës), (v) vende për relaksim (sallone bukurie dhe masazhi), (vi) bujqësi, (vii) turizëm, (viii) ) pastrim dhe (ix) shërbime të mirëmbajtjes, (x) agjenci të modelimit, (xi) sharrëxhinj, (xii) blegtori dhe (xiii) pylltari.<sup>72</sup>

Janë bërë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin për rrezikueshmërinë e punëtorëve sezonalë, si dhe kapacitetin e inspektoratit të punës dhe ekipeve të lëvizshme. Megjithatë, kapaciteti për të identifikuar rastet e shfrytëzimit për punë është ende i kufizuar, siç është edhe kapaciteti për të ndjekur penalisht raste të tilla.

Shpërndarja e informacionit dhe koordinimi i institucioneve brenda vendit dhe ndërkombëtarisht është gjithashtu një çështje shqetësuese,

Propozimet e **mëposhtme për veprim** bazohen në analizën e bazuar në rrezik të bërë në studim dhe plotësojnë dhe zgjerojnë rekomandimet e bëra në raportin e vitit 2017 të zhvilluar në kuadër të projektit HF I.

---

<sup>71</sup> BE SOCTA 2021 EUROPOL [https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/documents/socta2021\\_1.pdf](https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/documents/socta2021_1.pdf)

<sup>72</sup> KiE, Sanija Burageva, OJQ Porta e Hapur dhe Qendra për Studimin e Demokracisë, zbulimin proaktiv dhe me ndjeshmëri gjinore, identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë, qershor 2021, Shkup.

## **Veprimet e përgjithshme**

- Ratifikimi dhe zbatimi i protokollit të 2014-ës për konventën e punës së detyrueshme të ONP-së, 1930
- Miratimi i planeve kombëtare të veprimit për biznesin, veçanërisht për kompanitë më të mëdha tregtare, për të zbatuar parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë masat përkatëse për trajtimin e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim shfrytëzimin për punë.
- Miratimi i akteve detyruese për zbulimin e detyrueshëm publik të informacionit lidhur me punën e personave juridikë dhe zbulimi publik i sanksioneve dhe kundërvajtjeve të shqiptuara për personat juridikë të lidhur me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Integrimi i parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore në politikat e prokurimit publik dhe promovimi i transparencës në zinxhirët e furnizimit.

## **Veprimet për të parandaluar trafikimin me qenie njerëzore duke mbyllur boshllëqet në politika dhe praktikë**

- Përmirësimi i bazës së të dhënave të Prokurorisë Publike për të mundësuar rikodimin e llojit të shfrytëzimit në rastet e trafikimit.
- Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të organeve të prokurorisë për masat e veçanta procedurale për mbrojtjen e fëmijëve viktimë për të shmangur viktimizimin e tyre dytësor.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet e tjera dhe përdorimi i procedurave të ndihmës së ndërsjellë juridike për të marrë informacion të detajuar kur ekziston dyshimi se shtetasit maqedonas kanë qenë viktimë të punës së detyruar jashtë vendit.
- Sigurimi i mbrojtjes së duhur juridike dhe psikosociale për qytetarët e Maqedonisë të cilët ishin viktimë të punës së detyruar jashtë vendit dhe punojnë për riintegrimin e tyre për parandalimin dhe ritrafikimin.
- Rritja e kapaciteteve teknike, njerëzore për gjurmimin, mbledhjen e informacionit për qëllime të inteligjencës dhe përdorimin e tyre si prova materiale në proceset gjyqësore nëpërmjet OSINT, Dark Web, etj.



- Hartimi i një plani veprimi për rritjen e numrit të qendrave strehimore të financuara nga shteti të menaxhuara nga OJQ të regjistruara si ofrues të shërbimeve sociale sipas Ligjit për mbrojtjen sociale
- Përmirësimi i mundësive të punësimit për viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës nëpërmjet masave dhe subvencioneve të veçanta dhe të posaçme, duke përfshirë rishikimin e programeve aktuale kundër papunësisë.
- Përmirësimi i shërbimeve të komunitetit për të identifikuar fëmijët në rrezik të trafikimit për shfrytëzim pune dhe për të mbështetur fëmijët viktimat të dhunës, fëmijët romë dhe të rriturit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit ndërsektorial.

## **Veprime për të zvogëluar rrezikun e trafikimit ndërmjet punëtorëve dhe komuniteteve të rrezikuara**

### **Romë**

- Sigurimi i qasjes dhe përfshirjes së grave romë në arsim, duke ofruar mbështetje për vazhdimin dhe përfundimin e arsimit formal, veçanërisht në mesin e nënave beqare dhe të papunëve afatgjatë. Mbështetja e qasjes në kualifikimin profesional dhe trajnimin profesional të grave, vajzave, të papunëve afatgjatë, personave nga grupet e marginalizuara, viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit.
- Përmirësimi i shërbimeve të komunitetit për të identifikuar fëmijët romë në rrezik trafikimi për shfrytëzim pune dhe për të mbështetur fëmijët romë viktimat të dhunës dhe të rriturit, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit ndërsektorial.
- Përfshirja e plotë e fëmijëve romë në arsim, përfshirë të kthyerit, fëmijët me status të parregulluar dhe fëmijët pa identifikim personal.
- Sigurimi i trajnimit dhe asistencës profesionale në procesin e kërkimit të punës, qasje në tregun e punës, të drejtat e punës dhe qasje në arsim në komunitetin rom, me fokus të rinjtë dhe gratë.
- Hartimi dhe zbatimi i masave kundër varfërisë për komunitetin rom.

## **Punëtorët migrantë**

- Përmirësimi i qasjes në mbështetje ligjore dhe psiko-sociale për viktimat e huaja të trafikimit të qenieve njerëzore të vendosura në qendrën për të huajt Gazi Baba përmes vizitave të rregullta nga përfaqësuesit e ekipeve mobile.
- Ndërtimi i kapaciteteve për të regjistruar të gjithë migrantët dhe refugjatët që kalojnë tranzit nëpër vend, në mënyrë që të përmirësohet identifikimi i viktimave.
- Zhvillimi i një sistemi për të siguruar që viktimat e huaja të trafikimit të qenieve njerëzore të kenë një përkthyes.
- Konsideroni gratë dhe vajzat e gjetura gjatë inspektimeve në baret e natës si viktimat të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe siguroni atyre informacion, qasje në përkthyes, ndihmë juridike, strehim të sigurtë si dhe ndihmë mjekësore dhe psikologjike. Sigurohuni që ato të mos kthehen/dëbohen menjëherë në vendin e tyre të origjinës.

## **Punonjës të rrezikuar/të rinj**

- Fillimi i hetimeve proaktive, të koordinuara ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse dhe mbështetja e mbledhjes së provave materiale dhe krijimi i një baze të përbashkët të dhënash të institucioneve në grupin e punës për trafikimin e qenieve njerëzore.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore, OJQ-ve, sindikatave dhe kompanive private në identifikimin e viktimave të shfrytëzimit për punë.
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi për njohjen dhe zbatimin e aspekteve gjinore dhe masave dhe mekanizmave të duhur për të ndihmuar, mbrojtur dhe fuqizuar viktimat. Integrimi i perspektivës gjinore në planifikimin, vendimmarrjen dhe politikëbërjen në nivel lokal dhe kombëtar

## **Operacionet e biznesit dhe zinxhirët e furnizimit**

- Kryerja e më shumë inspektimeve të përbashkëta nga institucionet përgjegjëse (Ministria e Punëve të Brendshme, anëtarët e task-forcës, inspektorati i punës,

ekipet mobile) në sektorë që konsiderohen me rrezik të lartë, duke përfshirë: ndërtimtarinë, industrinë e tekstilit dhe këpucëve, klubet e natës (veçanërisht ato që ndodhen në pjesët perëndimore të vendit), shërbimet e bujqësisë, turizmit, pastrimit dhe mirëmbajtjes.

- Nxisni, në veçanti, kompanitë më të mëdha që operojnë në sektorë me rrezik si bujqësia, ndërtimi, hoteleria, për të prezantuar një mjet vetëvlerësimi në lidhje me faktorët e rrezikut për shfrytëzimin e punëtorëve në punë.

## Bibliografia

Iniciativa e Shoqatës së Intelektualëve të Papunë, analizë e hulumtimit të kryer për arsyet e mungesës nga procesi arsimor i nxënësve romë nga Vinica dhe Koçani për shkak të punës sezonale, 2019

Komiteti i Ministrave të KiE-së, Vendimi CM/Del/Dhje(2019)129/2, 2019

KiE, Mike Dottridge, Praktika e mirë e shfaqur nga institucionetshtetërore, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile në fushën e zvogëlimit të kërkesës për trafikimin e qenieve njerëzore për shfrytëzimin për punë, 2016

KiE, Sanija Burageva, OJQ Porta e Hapur dhe Qendra për Studimin e Demokracisë, zbulimin proaktiv dhe me ndjeshmëri gjinore, identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit me qëllim të shfrytëzimit për punë, qershor 2021, Shkup

KiE, Sanija Burageva, Udhëzues xhepi për Inspektorët e Punës, rev.2019

Studimi i politikës CRPM 39: Nga hija te punëtori sezonal i dukshëm në bujqësi: arsyet, sfidat dhe modelet për formalizimin e punës sezonale në sektorin e bujqësisë, 2020.

Raporti i progresit i KE-së (2021) Maqedonia e Veriut 2021

Raporti i KE-së nga Komisioni për Parlamentin Europian dhe Këshillin: Raporti i tretë mbi progresin e bërë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore siç kërkohet sipas nenit 20 të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Komisioni Evropian, 2020

Strategjia e BE-së për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore (2021-2025) | Së bashku kundër trafikimit të qenieve njerëzore (europa.eu)

Finance Think, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, Studimi i Politikave Nr. 36, Efekti i Kovid-19 mbi punëtorët e pasigurt në Maqedoninë e Veriut, ndjekja e punëtorëve me paga të ulëta, punëtorëve të papaguar të familjes, punëtorëve shtëpiak me pagesë, punëtorëve me kontrata pune atipike dhe punëtorëve informalë, 2021

GRETA(2020)08 Përmbledhje e praktikave të mira në trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë, 2020

GRETA, Raporti i 7-të i përgjithshëm mbi aktivitetet e GRETA-s, 2017

GRETA, Raporti i 9-të i përgjithshëm mbi aktivitetet e GRETA-s, 2020

GRETA, Shënim udhëzues për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të shfrytëzimit për punë, 2020

GRETA, Raporti i dytë në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", 2017

ONP, Programi i vendit për punë të denjë 2019;2022

Klara Skrivankova, Midis punës së denjë dhe punës së detyruar: shqyrtimi i vazhdimësisë së shfrytëzimit, Fondacioni Joseph Rowntree, nëntor 2010

Ligji i Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedurën penale, 150/2010, 100/2012, 142/2016, 193/2016, 198/2018

Lazetic & Zdravkova, Të drejtat e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në procesin gjyqësor, 2020

Luludi, Analiza e gjetjeve të hulumtimit në lidhje me perceptimet dhe të kuptuarit e trafikimit të qenieve njerëzore në mesin e nxënësve të shkollave të mesme, 2021

Raporti MYLA, Gjendja e azilit në Maqedoni për vitin 2018 dhe 2019

Komisioni kombëtar për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimit të paligjshëm, Raportet e Komisionit Kombëtar, 2019 dhe 2020

RBE - Ballkani Perëndimor - Statistikat e azilit - Përmbledhje e tendencave kryesore të vëzhguara që nga 01 tetori 2021

Enti Shtetëror i Statistikave, 2021, Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut

Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MAKStat, 2021

PACE - Rezoluta 2311 (2019) mbi të drejtat e njeriut dhe biznesin

Raporti Global UNODC mbi Trafikimin e Njerëzve, 2020

Ballkani Perëndimor - Refugjatët, azilkërkesit dhe njerëzit e tjerë në lëvizje të përziera, deri në fund të tetorit 2021

Banka Botërore, 2021, Gjelbërimi i Rimëkëmbjes, Ballkani Perëndimor nr. 20

# SHTOJCA I. Vështrim i përgjithshëm i instrumenteve ndërkombëtare përkatëse

<b>Puna e detyruar dhe e detyrueshme</b>	
<b>Instrumenti ndërkombëtar</b>	<b>Përkufizim/referencë</b>
1930 Konventa e punës së detyrueshme	Neni 2(1): E detyruar ose e detyrueshme do të thotë çdo punë ose shërbim që kërkohet nga çdo person nën kërcënimin e ndonjë dënimi dhe për të cilin personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht.
2000 Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të njerëzve veçanërisht grave dhe fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar	<p>Puna e detyruar nuk përkufizohet, por përmendet si një nga qëllimet e shfrytëzimit për të cilin trafikohen njerëzit.</p> <p>Neni 3 (a): Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.</p>

<p>2005 Konventa e Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore</p>	<p>Puna e detyruar nuk përkufizohet, por përmendet si një nga qëllimet e shfrytëzimit për të cilin trafikohen njerëzit.</p> <p>Neni 4(a): Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikatat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.</p>
<p>2011 Direktiva e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij</p>	<p>Puna e detyruar nuk përkufizohet, por përmendet si një nga qëllimet e shfrytëzimit për të cilin trafikohen njerëzit.</p> <p>Neni 2(2): Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose shërbime, duke përfshirë lypjen, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë, ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, apo heqjen e organeve.</p>

<p>2014 Protokoll i konventës së punës së detyrueshme</p>	<p>Nuk përcakton punën e detyruar ose të detyrueshme, por ripohon përkufizimin e Konventës së 1930-ës. Protokoll mbulon veprime specifike kundër trafikimit të personave për qëllime të punës së detyruar ose të detyrueshme (Neni 1.3).</p>
<p><b>Puna e fëmijëve<sup>73</sup></b></p>	
<p>Instrumenti ndërkombëtar</p>	<p>Përkufizim/referencë</p>
<p>Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)</p>	<p>ONP e përcakton "punën e fëmijëve" si punë që ua privon fëmijëve fëmijërinë, potencialin dhe dinjitetin e tyre dhe që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor. I referohet punës që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ është mendërisht, fizikisht, socialisht ose moralisht e rrezikshme dhe e dëmshme për fëmijët; dhe</li> <li>▪ ndërhyt në shkollimin e tyre duke ua hequr mundësinë për të ndjekur shkollën duke i detyruar ata të lënë shkollën para kohe; ose duke u kërkuar atyre që të përpiqen të kombinojnë frekuentimin e shkollës me punë tepër të gjatë dhe të rëndë.</li> </ul>

<sup>73</sup> Konventat 138 dhe 182 janë konventa themelore. Kjo do të thotë që edhe shtetet anëtare që nuk i kanë ratifikuar ende këto konventa duhet të respektojnë, promovojnë dhe realizojnë parimet e këtyre konventave.



<p>Konventa e 1973 mbi moshën minimale për pranim në punësim dhe punë, (Nr. 138)</p>		<p><b>Mosha minimale në të cilën fëmijët mund të fillojnë punën</b></p>	<p><b>Përgjashtimet e mundshme për vendet në zhvillim</b></p>
<p>Konventa përcakton parimet në lidhje me moshën minimale të pranimit për punësim ose punë</p>	<p><b>Puna e rrezikshme</b></p> <p>Çdo punë që ka të ngjarë të rrezikojë shëndetin fizik, mendor ose moral, sigurinë ose moralin e fëmijëve nuk duhet të bëhet nga askush nën moshën 18 vjeç.</p>	<p><b>18 (16 në kushte të rrepta)</b></p>	<p><b>18 (16 në kushte të rrepta)</b></p>

<p>Konventa e 1973 mbi moshën minimale për pranim në punë dhe punësim, (Nr. 138)</p> <p>Konventa përcakton parimet në lidhje me moshën minimale të pranimit për punësim ose punë</p>		<b>Минимална-та возраст на која децата можат да почнат со работа</b>	<b>Можни исклучоци за земјите во развој</b>
	<p><b>Mosha bazë minimale</b></p> <p>Mosha minimale për punë nuk duhet të jetë nën moshën për mbarimin e shkollimit të detyrueshëm dhe në çdo rast jo më pak se 15 vjeç.</p>	<b>15</b>	<b>14</b>
	<p><b>Puna e lehtë</b></p> <p>Fëmijët nga mosha 13 deri në 15 vjeç mund të bëjnë punë të lehta, përderisa kjo nuk kërcënon shëndetin dhe sigurinë e tyre, ose pengon arsimimin ose orientimin dhe formimin e tyre profesional.</p>	<b>13-15</b>	<b>12-14</b>

<p>Konventa e 1989-ës për të drejtat e fëmijës</p>	<p>Neni 32 specifikon "të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që mund të jetë e rrezikshme ose të ndërhyjë në edukimin e fëmijës, ose të jetë e dëmshme për shëndetin ose zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror të fëmijës." Nuk përcakton punën e fëmijëve; mbulon aktin në kuadrin e shfrytëzimit ekonomik.</p>
<p>1999 Konventa për format më të këqija të punës së fëmijëve (Nr. 182)</p>	<p>Neni 3(a) përkufizon format më të këqija të punës së fëmijëve si "të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria e borxhit dhe robëria dhe puna e detyruar ose e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar ose të detyrueshëm të fëmijëve për përdorim në konflikt të armatosur."</p>

<b>Trafikimi i qenieve njerëzore (njerëzve)</b>	
<b>Instrumenti ndërkombëtar</b>	<b>Përkufizim/referencë</b>
Konventa e skllavërisë 1926	Konventa e skllavërisë nuk përcakton trafikimin e qenieve njerëzore. Neni 1(2) që mbulon tregtinë e skllavërie mund të konsiderohet si një pararendës i përkufizimit të mëvonshëm të trafikimit. <sup>74</sup> Tregtia e skllavërie përfshin të gjitha veprimet e përfshira në kapjen, blerjen ose asgjësimin e një personi me qëllim për ta kthyer atë në skllavëri; të gjitha veprimet e përfshira në blerjen e një skllavi me qëllim shitjen ose shkëmbimin e tij; të gjitha aktet e disponimit me shitje ose shkëmbim të një skllavi të fituar me synimin për t'u shitur ose shkëmbyer, dhe, në përgjithësi, çdo akt tregtie ose transporti me skllavëri.
2000 Protokoli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të njerëzve veçanërisht grave dhe fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar	Neni 3(a) përkufizon "trafikimin e personave" si rekrutim, transport, transferim, strehim ose pranim të personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hiles, shpërdorimit të pushtetit ose të një pozicioni të cënueshëm ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.

<sup>74</sup> Weissbrodt, D., Dottridge M., Heqja e skllavërisë në format e saj bashkëkohore. OKB OHCHR, 2002, fq.18

<p>2005 Konventa e Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore</p>	<p>Neni 4 (a): "Trafikim i qenieve njerëzore" do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hiles, abuzimit me pushtetin ose të një pozicioni të rrezikueshmërisë ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.</p>
<p>2011 Direktiva e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij</p>	<p>Neni 2 (1) e përcakton trafikimin e qenieve njerëzore si "rekrutim, transport, transferim, strehim ose pritje të personave, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi ata persona, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, të hiles, të shpërdorimit të pushtetit ose të një pozicioni të rrezikuar ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi".</p>

<p>2014 Protokoli i konventës së punës së detyrueshme</p>	<p>Nuk e përcakton trafikimin e qenieve njerëzore. Protokoli mbulon veprime specifike kundër trafikimit të personave për qëllime të punës së detyruar ose të detyrueshme (Neni 1.3).</p>
<p><b>Shfrytëzimi/kushtet e punës shfrytëzuese</b></p>	
<p>2000 Protokoli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të njerëzve veçanërisht grave dhe fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar</p>	<p>Shfrytëzimi përkufizohet si një listë jo shteruese e manifestimeve të trafikimit.</p> <p>Neni 3(a) përkufizon "trafikimin e personave" si rekrutim, transport, transferim, strehim ose pranim të personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hiles, shpërdorimit të pushtetit ose të një pozicioni të rrezikuar ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.</p>

<p>2005 Konventa e Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore</p>	<p>Shfrytëzimi përkufizohet si një listë jo shteruese e manifestimeve të trafikimit.</p> <p>Neni 4 (a): "Trafikim i qenieve njerëzore" do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hiles, abuzimit me pushtetin ose të një pozicioni cenusshmërie ose të dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.</p>
<p>Direktiva e BE-së e vitit 2009 që siguron standarde minimale për ndëshkimet dhe masat kundër punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht</p>	<p>Neni 2 (i) përkufizon "kushtet veçanërisht shfrytëzuese të punës" si kushte pune, duke përfshirë ato që rezultojnë nga diskriminimi me bazë gjinore ose ndonjë diskriminim tjetër, ku ka një disproporcion të habitshëm në krahasim me kushtet e punësimit të punëtorëve të punësuar ligjërisht, të cilat, për shembull, ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve dhe e cenojnë dinjitetin njerëzor.</p>

<p>2011 Direktiva e BE-së për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij</p>	<p>Shfrytëzimi përkufizohet si një listë jo shteruese e manifestimeve të trafikimit.</p> <p>Neni 2(3): Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë të detyruar ose shërbime, duke përfshirë lypjen, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë, ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, apo heqjen e organeve.</p>
<p>Agjencia e BE-së për të drejtat themelore</p> <p>raporti i vitit 2015: Shfrytëzimi i rëndë për punë: punëtorët që lëvizin brenda ose në Bashkimin Evropian. Detyrimet e shteteve dhe të drejtat e viktimave fq.10</p>	<p><b>Shfrytëzimi i rëndë për punë</b></p> <p>Termi "shfrytëzim" nënkupton situatat e punës që devijojnë ndjeshëm nga kushtet standarde të punës siç përcaktohen nga legjislacioni ose rregullore të tjera ligjore detyruese, që kanë të bëjnë veçanërisht me shpërblimin, orët e punës, të drejtat e pushimit, standardet e shëndetit dhe sigurisë dhe trajtimin e denjë.</p> <p>Termi "i rëndë" i referohet formave të shfrytëzimit të punëtorëve që janë kriminale sipas legjislacionit të shtetit anëtar të BE-së ku ndodh shfrytëzimi. Prandaj, shfrytëzimi i rëndë i punës përfshin forma shtrënguese të shfrytëzimit, të tilla si skllavëria, robëria, puna e detyruar ose e detyrueshme dhe trafikimi (neni 5 i Kartës së të Drejtave Themelore), si dhe shfrytëzimi i rëndë brenda kornizës së një marrëdhënie pune, në veçanti situatat e punësimit të mbuluara nga neni 9 (1) i Direktivës për Sanksionet e Punëdhënësit.</p>



## SHTOJCA II. Vështrim i përgjithshëm i rastit "Serbaz"<sup>75</sup>

Aplikantët, 33 shtetas të Bosnjës dhe Hercegovinës, u rekrutuan dhe u dërguan në Azerbajxhan si punëtorë të huaj ndërtimi për një kompani ndërtimi, Serbaz Dizajn dhe Ndërtim Sh.PK ("Serbaz", një kompani e regjistruar në Azerbajxhan). Ata qëndruan në Azerbajxhan për periudha prej gjashtë muajsh ose më shumë. Aplikantët pretenduan, ndër të tjera, se gjatë kësaj periudhe kanë qenë viktimë të punës së detyruar dhe trafikimit me qenie njerëzore, kanë punuar pa kontrata dhe leje pune, u janë marrë dokumentet dhe u është kufizuar liria e lëvizjes nga punëdhënësi dhe nuk u janë paguar pagat duke filluar nga maji 2009 dhe deri në largimin e tyre nga Azerbajxhani. Padi civile që ata ngritën kundër Serbazit para gjykatave të Azerbajxhanit pas kthimit të tyre në Bosnje dhe Hercegovinë duke kërkuar paga të papaguara dhe dëme jomateriale për "shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre" të pretenduara ishte e pasuksesshme. Ankesa e tyre dhe ankesa e kasacionit gjithashtu u hodhën poshtë.

Pas një hetimi penal për akuzat për punë të detyruar dhe trafikim nga menaxhmenti dhe punonjësit e Serbazit, Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës filloi një procedim penal kundër trembëdhjetë shtetasve të Bosnjë-Hercegovinës. Në kuadër të këtyre procedurave, institucionet e Bosnjë-Hercegovinës iu bënë tre kërkesa për ndihmë ligjore institucioneve të Azerbajxhanit, duke iu referuar pretendimeve në lidhje me situatën në Serbaz.

Ankuesit u ankuan se shteti i paditur nuk kishte përmbushur detyrimin e tij procedural për të hetuar pretendimet e tyre.

Ligji – Neni 4 § 2

(a) Zbatueshmëria - Gjykata konstatoi se tërësia e argumenteve dhe parashtrësive të kërkuësve të bëra si përpara gjykatave

---

<sup>75</sup> [Zoletic dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit - 20116/12.](#)

vendase në padinë e tyre civile ashtu edhe para Gjykatës, përbënte një "pretendim të argumentueshëm" se ata i ishin nënshtruar trafikimit ndërkufitar të qenieve njerëzore dhe punës së detyruar ose të detyrueshme në territorin e Azerbajxhanit, ndër të tjera, nga disa autorë të dyshuar të cilët kishin qenë banues në Azerbajxhan. Veçanërisht:

Së pari, nga dosja e çështjes doli se periudha gjatë së cilës aplikantët kishin punuar në Azerbajxhan kishte përkuar, plotësisht ose të paktën pjesërisht, me periudhën në lidhje me të cilën ishin ngritur ankesat në përgjithësi për situatën në Serbaz, përkatësisht maj deri në nëntor 2009. Së dyti, Gjykata mori parasysh përshkrimin e përgjithshëm të kushteve të punës dhe të jetesës të parashikuara në padinë civile të ankuesve, si dhe materialin shtesë në të cilin ata ishin mbështetur si përpara gjykatave vendase ashtu edhe para Gjykatës. Më konkretisht ata i ishin referuar një raporti (raportit "ASTRA") i datës 27 nëntor 2009 të përgatitur nga tre OJQ nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia në bashkëpunim me qendrën e migracionit të Azerbajxhanit ("AMC"). Ky raport ofronte një përshkrim më të detajuar të pretendimeve të bëra në lidhje me trajtimin e punëtorëve nga Serbazi dhe përmbante informacion shtesë për situatën e mundshme të punës së detyruar ose të detyrueshme dhe trafikimit me qenie njerëzore. Ekzistenca dhe përmbajtja e këtij raporti ishte vënë mjaftueshëm në vëmendjen e gjykatave vendase. Megjithëse një raport i OJQ-ve në vetvete nuk do të kishte vlerë të konsiderueshme provuese pa hetime të mëtejshme, duke pasur parasysh fushën e ekspertizës së OJQ-ve të përfshira, përkatësisht ndihmën për punëtorët migrantë dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, ku informacioni prima facie i dhënë në të përbënte që vërtetonte parashtrësit e aplikantëve. Më tej, kishte pasur informacione të tjera konfirmuese në lidhje me punëtorët të cilët thuhet se kishin qenë në të njëjtën situatë ose të ngjashme me aplikantët gjatë të njëjtës periudhë kohore, të cilave u ishte referuar nga ankuesit ose ishte sjellë ndryshe në vëmendjen e gjykatave vendase dhe institucioneve të tjera.

Pretendimet në lidhje me format fizike dhe format e tjera të ndëshkimeve, mbajtjen e dokumenteve dhe kufizimin e lëvizjes,

të shpjeguara me kërcënimet për arrestime të mundshme të aplikantëve nga policia vendase për shkak të qëndrimit të tyre të parregullt në Azerbajxhan, kanë qenë tregues të shtrëngimit të mundshëm fizik dhe mendor dhe punës së nxjerrë nën kërcënimin e dënimit. Pretendimet për mospagesë të pagave dhe "gjoba" në formën e zbritjeve nga pagat, në lidhje me mungesën e lejeve të punës dhe qëndrimit, zbuluan një situatë të mundshme të cenueshmërisë së veçantë të aplikantëve si migrantë të parregullt pa burime. Këto pretendime sugjerorin se edhe nëse supozohej se në kohën e rekrutimit të tyre aplikantët ishin ofruar për punë vullnetarisht dhe kishin besuar me mirëbesim se do të merrnin pagat e tyre, situata mund të kishte ndryshuar më pas si rezultat i sjelljes së punëdhënësit të tyre. Në lidhje me këtë, ishin të rëndësishme edhe pretendimet për ndërrime të detyruara tepër të gjata në punë, mungesë të ushqyerjes dhe kujdesit të duhur mjekësor, si dhe tabloja e përgjithshme e atmosferës shtrënguese dhe frikësuese brenda Serbazit. Gjykata vlerësoi se të gjitha pretendimet e mësipërme, të marra së bashku, përbënin një pretendim të argumentueshëm se ankuesit i ishin nënshtruar një pune ose shërbimi që u ishte kërkuar nën kërcënimin e ndëshkimit dhe për të cilin ata nuk ishin ofruar vullnetarisht.

Për më tepër, tre elementët përbërës të trafikimit me qenie njerëzore ishin gjithashtu të pranishëm: fakti që aplikantët ishin rekrutuar në Bosnje dhe Hercegovinë, ishin sjellë në grupe në Azerbajxhan nga një kompani private dhe ishin vendosur kolektivisht në akomodime të caktuara, të cilat ata dyshohet se nuk mund t'i linin pa lejen e punëdhënësit, mund të ketë qenë "rekrutim, transport, transferim, strehim ose marrje e personave" ("veprim"); informacioni në Raportin ASTRA në lidhje me rrethanat e rekrutimit zbuloi një situatë të supozuar që mund të ishte rekrutuar me anë të mashtrimit ose hiles ("mjetet"); përfundimi i arritur në lidhje me argumentueshmërinë e pretendimit të tyre për "punë të detyruar ose të detyrueshme" shpaloste edhe qëllimin e mundshëm të shfrytëzimit në formën e punës së detyruar ("qëllim").

(b) Pajtueshmëria me detyrimet

(i) Nëse lindi një detyrim për të hetuar rastin në fjalë - Gjykata

konstatoi se e bëri, edhe pse vetë kërkuessit nuk kishin paraqitur një ankesë zyrtare penale, pasi vlerësoi se "pretendimi i tyre i argumentuar" ishte tërhequr mjaftueshëm dhe në mënyrë të përsëritur në vëmendjen e institucioneve vendase përkatëse në mënyra të ndryshme, si p.sh. letrat ankimore të AMC-së drejtuar institucioneve ligjzbatuese dhe sfidimi i saj për mosveprimtarinë e institucioneve para gjykatave vendase; padinë civile të kërkuessve dhe kërkesat për ndihmë juridike. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vuri në dukje se në kontekstin e detyrimeve pozitive sipas nenit 3 të Konventës, të cilat ishin të ngjashme me ato sipas nenit 4 të Konventës, informacione mjaftueshëm të detajuara që përmban një kërkesë ndërshtetërore për ndihmë juridike në lidhje me pretendimet vepra të rënda penale që mund të jenë kryer në territorin e shtetit që merr kërkesën mund të përbëjnë një "pretendim të argumentueshëm" të ngritur para institucioneve të atij shteti, duke nxitur detyrën e tij për të hetuar më tej këto pretendime.

Institucionet e Azerbajxhanit kishin qenë gjithashtu në dijeni të raportit të vitit 2011 të Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës ("ECRI") mbi Azerbajxhanin, sipas të cilit shumë punëdhënës që punësonin punëtorë migrantë në Azerbajxhan, përfshirë në sektorin e ndërtimit, kishin përdorur praktika të paligjshme punësimi dhe, si rezultat, migrantët e punësuar ilegalisht shpesh e gjetën veten të cenueshëm ndaj formave të rënda të abuzimit. Gjetjet e këtij raporti u zhvilluan më vonë në raportin e vitit 2014 të grupit të ekspertëve për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore të Këshillit të Evropës ("GRETA") në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga Azerbajxhani. Ky raport vërejti se zyrtarët e zbatimit të ligjit në Azerbajxhan thuhet se kishin një tendencë për të parë rastet e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim pune si thjesht mosmarrëveshje pune midis punëtorit dhe punëdhënësit dhe dukej se kishte një konfuzion midis rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim pune dhe mosmarrëveshjet në lidhje me pagat dhe aspekte të tjera të kushteve të punës. Edhe pse larg nga të qenit përfundimtar, konteksti i përgjithshëm i përshkruar në të dyja këto raporte ishte i rëndësishëm në vlerësimin e fakteve të rastit aktual.

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, institucionet kishin qenë të detyruara të vepronin me lëvizjen e tyre duke nisur dhe kryer një hetim efektiv.

(ii) Nëse ka pasur ndonjë hetim efektiv - Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë informacion apo koment në lidhje me ndonjë hetim të kryer nga institucionet vendase të zbatimit të ligjit, duke dështuar kështu të demonstronte se ishte kryer ndonjë hetim efektiv për pretendimet e kërkuësve. As nga shkresat e lëndës, përfshirë dokumentet e dorëzuara nga pala e tretë, nuk rezultonte se ndonjë hetim i tillë ishte kryer. Ndër të tjera, këto dokumente nuk përmbanin informacion në lidhje me përpjekjet për të identifikuar dhe vënë në dyshim ndonjë viktimë të supozuar të mundshme ose tashmë të identifikuar, përfshirë aplikantët. Për aq sa departamenti kundër trafikimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme kishte ditur se shumë viktima të supozuara ishin kthyer në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ishin informuar për procedurat penale atje, ky i fundit mund t'i kishte dërguar një kërkesë zyrtare për ndihmë ligjore institucioneve të atij vendi sipas Konventës së Ndihmës së Ndërsjellë, duke i kërkuar kësaj të fundit të identifikojë dhe marrë në pyetje viktima të tilla të mundshme dhe t'u sigurojë kopje të deklaratave të tyre institucioneve të zbatimit të ligjit në Azerbajxhan. Për më tepër, nuk ishte demonstruar se ishte bërë ndonjë përpjekje për të identifikuar dhe marrë në pyetje ndonjë nga personat e dyshuar të përfshirë që ishin shtetas ose banorë të Azerbajxhanit.

Kështu, shteti i paditur kishte dështuar në përputhje me detyrimin e tij procedural për të nisur dhe kryer një hetim efektiv të pretendimeve të kërkuësve në lidhje me punën e detyruar të pretenduar dhe trafikimin me qenie njerëzore.

Përfundim: shkelje e nenit 4 § 2 sipas detyrimit të tij procedural (njëzëri)

Neni 41: 5,000 euro për secilin prej aplikantëve për dëmin jopasuror; kërkesa në lidhje me dëmin material është hedhur poshtë.





Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës përmes projektit të përbashkët “Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut”. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

